Për më tepër bashkia Patos së bashku me ASHP-në është në fazën e lidhjes së kontratës me objekt “Pjesë këmbimi, goma, bateri dhe mirëmbajtje mjetesh”, me nr. REF-01916-04-18-2024, pasi mjetet që ASHP disponon për të kryer hapjen dhe rulimin e materialeve kanë pësuar difekte dhe kanë nevojë për riparime, ndodhur në këtë situatë e kemi punuar me mjete të reduktuara.

Nisur nga sezoni i vjeljeve të prodhimeve bujqësore në këto segmente ku jemi duke punuar hasemi me fermer të cilët qarkullojnë në këto rrugë për të shkuar në parcelat dhe serat e tyre dhe na duhet të ndërpresim punimet pasi rruga është një kalimshe dhe nuk ka hapësirë që të mund të punohet në një sens dhe në sensin tjetër të ketë qarkullim normal.

Çdo sasi materiali që furnizohet duhet të hapet dhe të shtrohet në moment pa u bërë penges për qarkullimin normal të fermerëve, në të kundërt nëse do e shkarkojmë materialin aty dhe mos ta hapim, rruga do të qëndroj e bllokuar.

Ky fakt na e bën të pamundur marrjen në dorëzim të sasive të mëdha të marrjes së materialit, por vijimin me sasi të cilat mund ti përballojmë.

Për nevoja të autoritetit kontraktor ky është modifikimi i dytë i kontratës brenda kohëzgjatjes së saj duke shtyrë afatin për arsyet e mësipërme.

10. Përshkrimi i modifikimit të kontratës/Marrëveshjes Kuadër, përfshirë natyrën dhe sasinë ose vlerën e mallrave:

Modifikimi i kontratës në këtë rast ka të bëjë me shtyrjen e afatit të kontratës nisur nga informacioni i datës 07.06.2024 nga Agjencia e Shërbimeve Publike Patos mbi zbatimin e kontratës me objekt “Blerje bazë materiale për mirëmbajtjen e rrugëve bujqësore”, sikundër ju jeni në dijeni kemi vijuar furnizimin pa ndërprerje furnizimin por procesi i hapjes, shtrimit, rulimit kërkon një kohë të gjatë pune, pasi gjendja

ekzistuese e rrugëve është amortizuar dhe më tej pas kalimit të stinës së dimrit me shira të shumtë ku janë dashur të kryen punime shtesë nga ana e Agjencisë së Shërbimeve Publike për skarifikimin e rrugëve, gërryerjen e sipërfaqes ku do të hapet materiali, sheshimin e trasesë dhe më pas vijimin në kushte normale të procesit të shtrimit të rrugëve me materialet që furnizohen nga ana juaj si kontaktor. Numri i objekteve që jemi duke punuar njëkohësisht është i konsiderueshëm, i cili kërkon disponueshmëri stafi dhe mjete të cilat janë të pamjaftueshme për të kryer punimet në të gjitha objektet dhe si pasojë ky fakt sjellë vonesa në hapjen dhe shtrimin e materialit të furnizuar.

Për më tepër bashkia Patos së bashku me ASHP-në është në fazën e lidhjes së kontratës me objekt “Pjesë këmbimi, goma, bateri dhe mirëmbajtje mjetesh”, me nr. REF-01916-04-18-2024, pasi mjetet që ASHP disponon për të kryer hapjen dhe rulimin e materialeve kanë pësuar difekte dhe kanë nevojë për riparime, ndodhur në këtë situatë e kemi punuar me mjete të reduktuara.

Nisur nga sezoni i vjeljeve të prodhimeve bujqësore në këto segmente ku jemi duke punuar hasemi me fermer të cilët qarkullojnë në këto rrugë për të shkuar në parcelat dhe serat e tyre dhe na duhet të ndërpresim punimet pasi rruga është një kalimshe dhe nuk ka hapësirë që të mund të punohet në një sens dhe në sensin tjetër të ketë qarkullim normal.

Çdo sasi materiali që furnizohet duhet të hapet dhe të shtrohet në moment pa u bërë penges për qarkullimin normal të fermerëve, në të kundërt nëse do e shkarkojmë materialin aty dhe mos ta hapim, rruga do të qëndroj e bllokuar.

Ky fakt na e bën të pamundur marrjen në dorëzim të sasive të mëdha të marrjes së materialit, por vijimin me sasi të cilat mund ti përballojmë.

Në total si pasojë e rrethanave të mësipërme gjatë kohëzgjatjes së kontratës janë shkaktuar vonesa në ecurinë e zbatimit prej 60 (gjashtëdhjetë) ditësh.

Si rrjedhojë autoriteti kontraktor nuk ka mundur të kryej marrjen e gjithë sasisë së prokuruar.

11. Vlera totale e kontratës së nënshkruar/marrëveshjes kuadër: 1,821,776 (një milion e tetëqind e njëzet e një mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e gjashtë) lekë me TVSH.

12. Vlera e ndryshuar (nëse është rasti): 0 (zero) lekë.

13. Kohëzgjatja e kontratës / Marrëveshjes Kuadër: 4 (katër) muaj. Me amendamentin nr. 1826/45 prot., datë 15.04.2024 është shtuar afati me 60 (gjashtëdhjetë) ditë. Dhe afati i ri (nëse është rasti): Shtim me 60 (gjashtëdhjetë) ditë.

14. Emri dhe adresa e operatorit/ëve Ekonomik:

“R E A L” Shpk Fier.

Nr.nipt-i: K32817410T.

Adresa: Fier, Cakran

Kontaktet: Telefoni : 0694037606; E-mail: realshpk@gmail.com

15. Data e nënshkrimit të modifikimit: 14/06/2024.

16. Burimi i financimit: Të ardhura Lokale.

17. Informacion tjetër që vlerësohet i nevojshëm nga autoriteti/enti kontraktor: \_\_\_\_\_.

# **NJOFTIME FITUESI PARAPRAK**

## **UNIVERSITETI ALEKSANDËR MOISIU DURRËS**

Drejtuar: “MARTINI KONSTRUKSION & REAL ESTATE ” SHPK me NUIS K81314023A  
Adresë: Rruga e Durrësit, Hyrja Nr.3 ,Pasuri e Llojit Njesi Nr.4/12+3-B/1, Zona Kadastrale 8210, Tiranë.

Procedura e prokurimit/lotit: Procedure e hapur e thjeshtuar

Numri i procedurës / referenca e Lotit: Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “Përshtatje ambienteve të brendshme në Fakultetin e Biznesit”, me Nr.REF-12152-07-04-2024; me fond limit 2 885 423 lekë (dy milion e tetëqind e tetëdhjetë e pesë mijë e katërqind e njëzet e tre) lekë pa T.V.SH, me kohëzgjatje 30 ditë nga momenti i nënshkrimit të kontratës.

Publikimet e mëparshme (*nëse është rasti*): Buletini i Njoftimeve Publike:

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik “DOKSANI - G” SHPK me NUIS L21809501H me ofertë ekonomike 2,380,790 (dy milion e treqind e tetëdhjetë mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë) lekë pa TVSH dhe 2,856,948 (dy milion e tetëqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e nëntëqind e dyzet e tetë) lekë me TVSH.
2. Operatori ekonomik “CARA” SHPK me NUIS K07729920F me ofertë ekonomike 2,432,808 (dy milion e katërqind e tridhjetë e dy mijë e tetëqind e tetë) lekë pa TVSH dhe 2,919,370 (dy milion e nëntëqind e nëntëmbëdhjetë mijë e treqind e shtatëdhjetë) lekë me TVSH.
3. Operatori ekonomik “HYSI-2 F” SHPK me NUIS K72429007E me ofertë ekonomike 2,165,900 (dy milion e njëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e nëntëqind) lekë pa TVSH dhe 2,599,080 (dy milion e pesëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e tetëdhjetë) lekë me TVSH.
4. Operatori ekonomik KOMBEAS Sh.A, me NUIS K88103301J me ofertë ekonomike 2,420,390 (dy milion e katërqind e njëzet mijë e treqind e nëntëdhjetë) lekë pa TVSH dhe 2,904,468 (dy milion e nëntëqind e katër mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e tetë) lekë me TVSH.
5. Operatori ekonomik “MARTINI KONSTRUKSION & REAL ESTATE ” SHPK me NUIS K81314023A me ofertë ekonomike 2,255,600 (dy milion e dyqind e pesëdhjetë e pesë mijë e gjashtëqind ) lekë pa TVSH dhe 2,706,720 (dy milion e shtatëqind e gjashtë mijë e shtatëqind e njëzet) lekë me TVSH.
6. Operatori ekonomik “MENI” SHPK me NUIS J61909018W me ofertë ekonomike 2,133,485 (dy milion e njëqind e tridhjetë e tre mijë e katërqind e tetëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH dhe 2,560,182 (dy milion e pesëqind e gjashtëdhjetë mijë e njëqind e tetëdhjetë e dy)lekë me TVSH.

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. Operatori ekonomik “DOKSANI - G” SHPK me NUIS L21809501H me ofertë ekonomike 2,380,790 (dy milion e treqind e tetëdhjetë mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë) lekë pa TVSH dhe 2,856,948 (dy milion e tetëqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e nëntëqind e dyzet e tetë) lekë me TVSH, nuk është në përputhje me kërkesat dhe specifikimet teknike të kërkuara në DST dhe oferta refuzohet pasi:
  - Nuk plotëson KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIMIT, pikën 2.3 Kapaciteti teknik, pikën 2.3.4 në të cilën përcaktohet: ”Operatori ekonomik duhet të disponoj punonjës të kualifikuar, me profesionet e përcaktuara si më poshtë:
    - 1 punonjës bojaxhi
    - 1 punonjës për punimet e gipsit
    - 1 punonjës marangoz
    - 1 punonjës elektrikist
    - 3 punëtorë ndërtimi të thjeshtë

Operatori ekonomik në shtojcën 8 FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT, Pjesa III, Kriteret e Përzgjedhjes /Kualifikimit, germa B: DEKLARATË ”Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate”, nuk ka deklaruar se disponon 3 punëtorë ndërtimi të thjeshtë.

2. Operatori ekonomik “HYSI-2 F” SHPK me NUIS K72429007E me ofertë ekonomike 2,165,900 (dy milion e njëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e nëntëqind) lekë pa TVSH dhe 2,599,080 (dy milion e pesëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e tetëdhjetë) lekë me TVSH, nuk është në përputhje me kërkesat dhe specifikimet teknike të kërkuara në DST dhe oferta refuzohet pasi:
  - Nuk plotëson KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIMIT, pikën 2.3 Kapaciteti teknik, pikën 2.3.1, pasi në dokumentacionin për punë të ngjashme nuk ka paraqitur - Aktin e kolaudimit.
3. Operatori ekonomik “MENI” SHPK me NUIS J61909018W me ofertë ekonomike 2,133,485 (dy milion e njëqind e tridhjetë e tre mijë e katërqind e tetëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH dhe 2,560,182 (dy milion e pesëqind e gjashtëdhjetë mijë e njëqind e tetëdhjetë e dy)lekë me TVSH, nuk është në përputhje me kërkesat dhe specifikimet teknike të kërkuara në DST dhe oferta refuzohet pasi:
  - Nuk plotëson KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIMIT, pikën 2.3 Kapaciteti teknik, pikën 2.3.7 në të cilën përcaktohet: ”Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose distributori për materialet (bojë). Në rast se do të paraqitet autorizim distributori, operatori ekonomik ta vërtetoj këtë duke paraqitur kontratë premtimi, letër angazhimi/akt-marrëveshje mes Kompanisë prodhuese dhe Distributorit të autorizuar, si dhe çdo dokumentacion tjetër ligjor të vlefshëm që provon lidhjen e distributorit të autorizuar me prodhuesin”, pasi operatori ekonomik nuk ka paraqitur dokumentacion për përbushjen e kësaj pike.

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë “MARTINI KONSTRUKSION & REAL ESTATE” SHPK, me NUIS K81314023A, me adresë “Rruga e Durrësit, Hyrja Nr.3, Pasuri e Llojit Njesi Nr.4/12+3-B/1, Zona Kadastrale 8210, Tiranë, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej

2,255,600 (dy milion e dyqind e pesëdhjetë e pesë mijë e gjashtëqind ) lekë pa TVSH dhe 2,706,720 (dy milion e shtatëqind e gjashtë mijë e shtatëqind e njëzet) lekë me TVSH, është identifikuar si fitues (paraparak) i procedurës së prokurimit.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.

## **GJYKATA ADMINISTRATIVE E SHKALLËS SË PARË TIRANË**

Drejtuar: Synapse ATS

Adresë: Rruga “Dritan Hoxha”, Pallati MC-Inerte, Kati 2, Tiranë, Shqipëri

Procedura e prokurimit: E hapur e thjeshtuar - Punë

Numri i procedurës: REF-12342-07-08-2024

Përshkrimi i shkurtër i kontratës:

Objekti i kontratës: “Rikonstruksion i plote i dhomes se Serverit” në ambientet e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë

Fondi limit: 10,833,000 (dhjetë milion e tetëqind e tridhjetë e tre mijë) Lekë pa TVSH

Kohëzgjatja e kontratës/ afati për zbatimin e saj: Kohëzgjatja e kontratës ose afati i zbatimit të kontratës është 45 (dyzet e pesë) ditë kalendarike duke filluar nga momenti i nënshkrimit të procesverbalit të fillimit të punimeve.

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti):

Buletini i Njoftimeve Publike : Buletini Nr. 27 date 27.05.2024

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Shoqëria "NDREGJONI" sh.p.k me NIPT K31329048I, ka paraqitur ofertën ekonomike me vlerë 10,140,000 (dhjetë milion e njëqind e dyzet mijë) Lekë pa Tvsh.
2. Shoqëria “Martini Konstruksion & Real Estate” sh.p.k me NIPT K81314023A ka paraqitur ofertën ekonomike me vlerë 8,658,900 (tetë milion e gjashtëqind e pesëdhjetë e tetë mijë e nëntëqind) Lekë pa Tvsh.

3. Shoqëria “Synapse ATS” sh.p.k me NIPT L12321011H ka paraqitur ofertën ekonomike me vlerë 9,960,150 (nëntë milion e nëntëqind e gjashtëdhjetë mijë e njëqind e pesëdhjetë) Lekë pa Tvsh.

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. Shoqëria "NDREGJONI" sh.p.k me NIPT K31329048I

Operatori Ekonomik "NDREGJONI" sh.p.k nuk kualifikohet për asyet e mëposhtme:

1. Operatori Ekonomik nuk ka paraqitur katalogun/et ose fragmente të katalogut/eve të prodhuesit/ve, ose skedat teknike të publikuara nga prodhuesi:
  - a) për sistemin automatik të detektimit dhe shuarjes së zjarrit me gas;
  - b) për PDU-të;
  - c) për rrjetin bakër dhe fibër;
  - d) për sistemin e monitorimit, kontrollit dhe menaxhimit (BMS);
  - e) për Rack-un.
2. Operatori Ekonomik, ka paraqitur katalogun/et ose fragmente të katalogut/eve të prodhuesit/ve, ose skedat teknike të publikuara nga prodhuesi:
  - a) për sistemin e kondicionimit, por pa një përkthim dhe noterizim në shqip,
  - b) për sistemin UPS, por pa një përkthim dhe noterizim në shqip,
  - c) për sistemin CCTV, por pa një përkthim dhe noterizim në shqip.
3. Operatori Ekonomik nuk ka paraqitur:
  - a) Certifikatë EN ISO 20000-1:2018 – që tregon nëse është i certifikuar për sistemet e menaxhimit të shërbimeve të teknologjisë së informacionit (Projektim, implementim, mirëmbajtje, asistencë dhe suport i sistemeve të teknologjisë së informacionit).
4. Operatori Ekonomik nuk e ka në fushën e veprimtarisë së tij objektin e prokurimit:
  - a) Projektim, ndërtim dhe implementim të Data Center

i cili ndër të tjera përfshin:

1. Instalimin/konfigurimin e sistemit të kondicionimit,
2. Instalimin/konfigurimin e sistemit të UPS,
3. Instalim/konfigurimin e sistemit të monitorimi, kontrolli dhe menaxhimi (BMS),

por Operatori Ekonomik nuk ka paraqitur as edhe punë të ngjashme ku të tregojë se ka përvojë të mëparshme në:

1. Instalim/konfigurim sistemi kondicionimi,
2. Instalim/konfigurim sistemi UPS,
3. Instalim/konfigurim sistemi monitorimi, kontrolli dhe menaxhimi (BMS),
4. Instalim sistemi shuarje zjarri me gas të pastër,

që janë sistemet kryesore dhe që zënë pjesën më të madhe të vlerës së projektit.

2. Shoqëria “Martini Konstruksion & Real Estate” sh.p.k me NIPT K81314023A

Operatori Ekonomik “Martini Konstruksion & Real Estate” sh.p.k, nuk kualifikohet për këto arsye:

Operatori Ekonomik “Martini Konstruksion & Real Estate”, nuk kualifikohet për këto arsye:

1. Operatori Ekonomik nuk ka paraqitur katalogun/et ose fragmente të katalogut/eve të prodhuesit/ve, ose skedat teknike të publikuara nga prodhuesi:
  - a) për PDU-të,
  - b) për Rack-un.
2. Operatori Ekonomik nuk ka paraqitur punë të ngjashme as në ente publike dhe as në sektorin privat, ku të dokumentojë që ka përvojë të mëparshme në “Projektim, ndërtim dhe implementim të Data Center”, ku ndër të tjera përfshihen punimet në lidhje me:

- a) Instalim/konfigurim sistemi kondicionimi,
  - b) Instalim/konfigurim sistemi UPS,
  - c) Instalim/konfigurim sistemi monitorimi, kontrolli dhe menaxhimi (BMS),
  - d) Instalim sistemi shuarje zjarri me gas të pastër,
- që janë sistemet kryesore dhe që zënë pjesën më të madhe të vlerës së projektit.
3. Operatori Ekonomik sipas katalogut të paraqitur ka ofruar UPS që nuk i plotëson specifikimet teknike e caktuara në projekt, konkretisht:
    - a) UPS i ofruar nga OE, e ka nivelin e zhurmës <55dB dhe jo <50dB,
    - b) UPS i ofruar nga OE, rregullimin e frekuencës në dalje nuk e ka të specifikuar,
    - c) UPS i ofruar nga OE, nuk ka ekran me prekje me ngjyra,
    - d) UPS i ofruar nga OE, nuk ka buton emergjence (EPO).
  4. Operatori Ekonomik ka paraqitur Sistem monitorimi, kontrolli dhe menaxhimi i cili monitoron parametra ambiental si temperatura, lagështira, tymi etj, por ky sistem nuk mundëson kontrollin apo menaxhimin e sistemeve që do të instalohen në dhomën e serverave.
  5. Sistemi i Monitorimit, Kontrollit dhe Menaxhimit (BMS) i ofruar nga Operatori Ekonomik:
    - a) Nuk mundet që në rastin e dedektimit të rrjedhjes së ujit të bllokojë furnizimin me ujë në dhomë. Po ashtu në rast të dedektimit të zjarrit nuk bëhet e mundur fikja e sistemit të kondicionimit. Ndërsa në rast se sistemi i zjarrit arrin në fazën e lëshimit të agjentit shuarës nuk bëhet e mundur hapja në mënyrë automatike e derës së dhomës së serverave. Kjo sepse sistemi i ofruar nga OE është thjesht sistemi monitorimi që mundëson vetëm regjistrimin e të dhënave të sensorëve, gjenerimin e grafeve të këtyre të dhënave, njoftim me e-mail dhe SNMP, monitorim nëpërmjet SNMP, përshkallëzimin e alarmeve por nuk mundëson kontrollin dhe menaxhimin e sistemeve të instaluar në dhomën e serverave.
    - b) Nuk mund të marrë informacione nga sistemi UPS mbi:
      - Nivelin e ngarkesës
      - Kohëzgjatjen e furnizimit nga bateria në varësi të ngarkesës
      - Statuset e punës në UPS (from line 1, from line 2, from battery, bypass)
      - Parametrat e energjisë në hyrje-dalje të pajisjes
      - Kohën kur duhet të merren masa nëse pjesët e brendshme të pajisjes janë amortizuar dhe duhet të ndërrohen
      - Alarmet e ndryshme në lidhje me punën e UPS
      - Historikun e eventeve
    - c) Nuk mund të marrë nga sistemi i kondicionimit informacionet si më poshtë:
      - Nivelin e temperaturës
      - Nivelin e lagështirës relative
      - Nivelin e lartë të presionit në qarkun ftohës
      - Gjendjen e filtrave
      - Mungesën ose tepicën e ujit në lagështues
      - Orët e punës së njësisë
      - Orët e punës se kompresorëve
      - Informacionin nëse është duke punuar në gjendje normale apo në alarm
      - Alarmet e ndryshme mbi punën e pajisjeve ftohëse
    - d) Nuk mund të marrë nga sistemi i dedektimit dhe shuarjes së zjarrit informacionet si më poshtë:
      - Statusin e sistemit (regjim normal apo fault)
      - Statusin Para-Alarm
      - Statusin Alarm (extinguish)
    - e) Nuk mund të marrë nga paneli elektrik informacionet si më poshtë:
      - Open/Close të automatëve



- Informacion nëse parametrat e furnizimit të energjisë elektrike janë jashtë diapazonit normal
- Dedektimin e mungesës së tensionit
- Asimetrinë e fazave
- Renditje të kundërt të fazave
- Nivel i lartë tensioni
- Nivel i ulët tensioni
- Frekuencë të ndryshme nga 50Hz
- Të gjitha paramentrat e multimetrit U, I, P, S, Q, Hz etj

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Shoqërinë “Synapse ATS” sh.p.k se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 9,960,150 (nëntë milion e nëntëqind e gjashtëdhjetë mijë e njëqind e pesëdhjetë) lekë pa Tvsh është identifikuar si fitues (paraprak) i procedurës së prokurimit.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.

### **KËSHILLI I QARKUT LEZHË**

Drejtuar: “KTHELLA” SH.P.K, NIPT J69303023D,

Adresa : Kompleksi Kthella Resort, Rruga "Shen Vicenzo De Paolo", perballë varrezave të Qytetit Rreshen, Koder Rreshen, Mirdite.

Procedura e prokurimit: E hapur e thjeshtuar

Numri i procedurës / referenca e Lotit: REF-08661-06-10-2024

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: *Rehabilitim Sheshi “Skenderbej”, Bashkia Kurbin*

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike [Data 10.06.2024] [Nr. 30]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomkisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomkisht më e favorshme bazuar në çmim x

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Shoqeria "KTHELLA" sh.p.k., me numer NIPT J69303023D, me vlere 7,670,315 (shtate million e gjashteqind e shtatedhjete mije e treqind e pesembedhjete) leke pa t.v.sh.

2- Shoqeria ASI INVEST sh.p.k., me numer NIPTI M01927023H, me vlere 8,202,541(tetemilion e dyqind e dy mije e peseqind e dyzet e nje) leke pa t.v.sh.

3- Shoqeria DOKSANI- G sh.p.k., me numer NIPT L21809501H, me vlere oferte 7.968.472,5 (shtate million e nenteqind e gjashtedhjete e tetemije e katerqind e shtatedhjete e dy presje pese) leke pa tvsh.

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. Shoqeria ASI INVEST sh.p.k., me numer NIPTI M01927023H, per arsyet e meposhtme: Operatori ekonomik nuk permbush piken 2.3.3/d te kriterëve te vecanta te DST, sepse sipas deklarimeve ne formularin e vetdeklarimit nuk rezulton se diponon 1 (një) punonjes i pajisur me çertifikate “Person pergjegjes per sigurine dhe shendetin ne pune per riskun e larte” e cila të jetë e lëshuar nga shoqeri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë

2. Shoqeria DOKSANI- G sh.p.k., me numer NIPT L21809501H, per arsyet e meposhtme : Operatori ekonomik nuk ka deklaruar ne formularin e vetdeklarimit të dhënat e Personit / personave në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, se nuk jane te denuar.

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë "KTHELLA" sh.p.k, me adrese “Kompleksi Kthella Resort, Rruga "Shen Vicenzo De Paolo", perballë varrezava të Qytetit Rreshen, Koder Rreshen, Mirdite”, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 7,670,315 (shtate million e gjashteqind e shtatedhjete mije e treqind e pesembedhjete) leke pa t.v.sh , është identifikuar si fitues (paraparak) i procedurës së prokurimit.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.

## **DREJTORIA E UJITJES DHE KULLIMIT KORÇË**

Për: BOE “SALILLARI” shpk Tiranë, me adresë: Berat Ura Vajgurore, Lagjia 4 Shtatori , nr Pasurie 1/28, Zona Kadastrale nr. 3682, Ura Vajgurore, Dimal (Ish Magazinat ), perballe Komisarariatit te Policise Ura Vajgurore, Bashkia Dimal,

&amp;

OE "Z D R A V A" shpk Lushnjë, me adresë: Fier Lushnje, Autostrada Lushnje-Fier km 4, Pasuria me nr 104/18 në zonën kadastrale 3268/9001.

\* \* \*

Procedura e prokurimit/lotit: Procedurë e Hapur, Kontratë për Punë Publike

Numri i procedurës / referenca e Lotit 3: REF-09456-06-14-2024

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: "Mbrojtje nga gerryerjet dhe përmbytja nga lumi Osum në Starovë - Remanicë".

Fondi limit: 104.364.594 (njqind e kater milion e treqind e gjashtedhjetë e kater mije e peseqind e nentedhjetë e kater) lekë pa tvsh.

Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin: brenda 6(gjashtë) muajve nga fillimi i punimeve.

Publikime të mëparshme(nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike nr. 32, datë 24.06.2024.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. BOE "SALILLARI" shpk, NUIS J62903125G (90,426%) & OE "Z D R A V A" shpk, me NUIS J84003411K (9,574%)

Vlera : 78.274.050,89 (shtatedhjetë e tete milion e dyqind e shtatedhjetë e kater mije e pesedhjetë presje tetedhjetë e nente) lekë pa tvsh.

2. BOE "BE - IS" shpk, me NUIS K71412003A (49,5%) & OE "2 T" shpk, me NUIS K01731001M (50,5%),

Vlera : 79.552.232 (shtatdhjetë nente milion e pesqind pesdhjetë dy mije e dyqind tridhjetë dy) lekë pa tvsh.

3. BOE "B93 II" shpk, me NUIS L522090500 (32,47%) & OE "B-93" shpk, me NUIS J62903508R (14,05%) & OE "ELMAZAJ KONSTRUKSION" shpk, me NUIS L33229401T (31,13%) & OE "ALB TIEFBAU" shpk, me NUIS J66703049C (22,35%)

Vlera : 85.362.690 (tetedhjetë e pese milion e treqind e gjashtedhjetë e dy mije e gjashteqind e nentedhjetë) lekë pa tvsh.

4. BOE "FLED" shpk, me NUIS K17621104C (40,54%) & OE "ASI-2A CO" shpk, me NUIS K53002402C (19,84%) & OE "DESARET COMPANY" shpk, me NUIS K01816001J (39,62%)

Vlera : 59.827.425 lekë (pesedhjetë e nente milion e teteqind e njezet e shtate mije e katerqind e njezet e pese) lekë pa tvsh.

5. BOE "DEHA 2010" shpk, me NUIS L03425410B (44%) & OE "Rroku GUEST" shpk, me NUIS K87921701H (56%),

Vlera : 66.420.060 (gjashtëdhjetë e gjashtë milion e katërqind e njëzetë mijë e gjashtëdhjetë)lekë pa tvsh.

6. OE "VELLEZERIT HYSA" shpk, me NUIS K12911201C

Vlera : 74.167.002 (shtatedhjetë e kater milion e njeqind e gjashtedhjetë e shtate mije e dy) lekë pa tvsh.

7. OE "STERKAJ" shpk, me NUIS J68310708M,

Vlera : 74.949.262,5 (shtatedhjetë e kater milion e nenteqind e dyzet e nente mije e dyqind e gjashtedhjetë e dy presje pesë) lekë pa tvsh.

8. OE "SHKELQIMI 07" shpk, me NUIS K68121808W,

Vlera : 85.383.407 (tetedhjetë e pese milion e treqind e tetedhjetë e tre mije e katerqind e shtate) lekë pa tvsh.

9. BOE "METEO" shpk, me NUIS L26310801C (92,3%) & OE "Shendelli" shpk, me NUIS K07924803N (7,7%),

Vlera : 74.924.115 (shtatëdhjetë e katër milion e nëntëqind e njëzet e katër mijë e njëqind e pesëmbëdhjetë) lekë pa tvsh.

\* \* \*

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. BOE "FLED" shpk, me NUIS K17621104C (40,54%) & OE "ASI-2A CO" shpk, me NUIS K53002402C (19,84%) & OE "DESARET COMPANY" shpk, me NUIS K01816001J (39,62%)
2. BOE "DEHA 2010" shpk, me NUIS L03425410B (44%) & OE "Rroku GUEST" shpk, me NUIS K87921701H (56%),
3. OE "VELLEZERIT HYSA" shpk, me NUIS K12911201C
4. OE "STERKAJ" shpk, me NUIS J68310708M,
5. OE "SHKELQIMI 07" shpk, me NUIS K68121808W,
6. BOE "METEO" shpk, me NUIS L26310801C (92,3%) & OE "Shendelli" shpk, me NUIS K07924803N (7,7%),

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

1. BOE "FLED" shpk, me NUIS K17621104C, i cili mer persiper 40.54% (dyzet presje pesedhjetë e kater) të vleres se punimeve, OE "ASI-2A CO" shpk, me NUIS K53002402C, i cili merr persiper 19.84% (nentembdhjete presje tetedhjetë e kater) të vleres se punimeve dhe OE "DESARET COMPANY" shpk, me NUIS K01816001J, i cili merr persiper 39.62% (tridhjetë e nente presje gjashtedhjetë e dy) të vleres se punimeve, me ofertë ekonomike: 59.827.425 lekë (pesedhjetë e nente milion e teteqind e njezet e shtate mije e katerqind e njezet e pese) lekë pa tvsh.

- BOE nuk plotëson kerkesat ligjore per “Kriteret e Vecanta te Kualifikimit”, pasi oferta e ketij bashkimi operatoresh rezulton anomalisht e ulet.

Bazuar ne VKM-ne Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, pika 2 - “Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme.”, pika 3 - “Ofertat e kualifikuara verifikohen nëse kanë apo jo gabime aritmetike.”, pika 4 - “Pas korrigjimit të gabimeve aritmetike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon nëse ofertat e vlefshme janë ose jo me çmim anomalisht të ulët sipas formulës së përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit”, KVO ka ndjekur hapat e sipercituara duke skualifikuar fillimisht ofertat te cilat nuk përmbushin kerkesat per kualifikim, ka verifikuar dhe ka konstatuar se ofertat e vlefshme nuk kane gabime aritmetike dhe me pas ka zbatuar formulen per oferten anomalisht te ulet si ne vijim: “Në rastin kur janë të vlefshme tri ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme”. Vlera prag, e llogaritur nga formula per kete prokurim eshte 64.249.887,19 (gjashtedhjet e kater milion e dyqind e dyzet e nente mije e teteqind e tetedhjet e shtate presje nentembedhjet) lek pa tvsh. Krahasuar me kete vlere, oferta e paraqitur nga BOE rezulton me cmim anomalisht te ulet.

Referuar ndryshimeve te ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” te cilat kane hyre ne fuqi ne dt 20.03.2024, ne nenin 93 “Oferta anomalisht e ulet” eshte shtuar pika 5 ku citohet: “Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, autoritetet ose entet kontraktore refuzojnë pa kërkuar shpjegime një ofertë, e cila është konstatuar anomalisht e ulët”. Ne rastin ne fjale, vlera e fondit limit te ketij Loti eshte nen kufirin e larte monetar.

Ne nenin 134 “Dispozita kalimtare”, pika 3 citohet: “Procedurat e prokurimit të nisura përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji do të vijojnë të realizohen sipas parashikimeve të ligjit në fuqi në momentin e fillimit/nisjes së tyre”. Urdheri i prokurimit per proceduren me REF-09456-06-14-2024 ka dale ne dt 10.06.2024 dhe DST jane publikuar ne dt 14.06.2024, pra sipas percaktimeve te mesiperme ligjore OE per plotesimin e ofertes duhet ti referoheshin ndryshimeve ligjore qe kane hyre ne fuqi ne dt 20.03.2024. Per te qene sa me transparent dhe njekoheisht per t’ju ardhur ne ndihme OE ofertues, Njesia e Prokurimit ne DST ka vendosur Shënimin: Operatorët ekonomik gjatë plotësimit të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8, duhet të kenë parasysh përcaktimet e dokumentit “Sjellje në Vëmendje”, Nr. 918 prot., datë 02.02.2022, të publikuar në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik. si dhe ndryshimet e ligjit Nr 162 “Per Prokurimin Publik” hyre ne fuqi dt 20.03.2024.

Per te mos pasur asnje keqkuptim ne zbatimin e ketyre ndryshimeve DUK Korce ne rolin e AK i ka cuar shkrese zyrtare “Kerkese per sqarim” APP-se, me Nr 205 prot date 07.05.2024, ku i kerkon sqarim mbi zbatimin nga ana e AK te ndryshimeve ligjore qe ka pesuar ligji nr.162/2020 “Për prokurimin publik”. Me shkrese Nr 205/1 prot date 09.05.2024 eshte kthyer pergjigje nga APP ku citohet se: “Sikurse jeni ne dijeni edhe prej njoftimit te nxjerre ne faqen zyrtare te APP, ndryshimet qe ka pesuar Ligji Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik”, te miratuara me Ligjin Nr. 16/2024 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, hynë në fuqi në datë 20 Mars 2024....Sikurse ju eshte bere me dije edhe me njoftimin e nxjerre ne faqen e APP, procedurat e prokurimit të nisura përpara datës 20 Mars 2024 do të vijojnë të realizohen sipas parashikimeve të ligjit në fuqi në momentin e fillimit/nisjes së tyre. Ndërsa, procedurat e prokurimit, që do të nisin (me

*nxjerrjen e urdhrorit të prokurimit) në datë 20 Mars e në vijim, do t'i nënshtrohen parashikimeve të reja ligjore*"

Në rast se bashkimi i operatorëve ekonomikë do të kishte paqartësi në lidhje me plotësimin e kërkesave të mësipërme, ka pasur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në 6 ditë para afatit perfundimtar të dorëzimit të ofertave parashikuar nga neni 75 i LPP-së, i ndryshuar. Është detyrë e operatorëve ekonomikë të përgatisin ofertat e tyre në përputhje me kriteret ligjore në fuqi dhe me kushtet e vendosura nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit për sa kohë që i kanë pranuar ato dhe nuk i kanë bërë në asnjë rast objekt-ankimimi.

Ne baze të ligjit 162/2020 "Per Prokurimin Publik" i ndryshuar, Neni 92, pika 3, - "Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit", KVO vendos se për arsyet e mesiperme ky subjekt: skualifikohet.

2. BOE "DEHA 2010" shpk, me NUIS L03425410B, i cili mer persiper 44% (dyzet e kater) të vleres se punimeve dhe OE "Rroku GUEST" shpk, me NUIS K87921701H, i cili merr persiper 56% (pesedhjetë e gjashte) të vleres se punimeve me ofertë ekonomike: 66.420.060 (gjashtëdhjetë e gjashtë milion e katërqind e njëzetë mijë e gjashtëdhjetë)lekë pa tvsh.
- BOE nuk plotëson kerkesat e pikes 2.3.1 te "Aftesise teknike dhe profesionale"ku kerkohet: *Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme sipas percaktimeve të VKM-se Nr. 285, datë 19.5.2021, neni 39, pika 5:*

OE "Rroku GUEST" sh.p.k nuk ploteson vleren e kerkuar per punet e ngjashme. OE ka paraqitur gjithesej 13 pune, prej te cilave 6pune jane ne perputhje me objektin e prokurimit, 5 pune jane "Sistemim + Asfaltim rruge", dhe 2 pune jane "Mirembajtje rutine rruge", per keto pune spjegojme se:

- Puna "Magjistrali Mat – Lezhe" nuk merret parasysh pasi eshte jashte afateve. Puna ka perfunduar ne dt 6.10.2018, pra jashte 5 viteve nga data e hapjes se ofertave.
- Puna "Rikonstruksion rruge Gjergj Jakin dhe rruga e Palokajve – Berdice e Madhe" nuk merret parasysh pasi eshte jashte afateve. Puna ka perfunduar ne dt 13.06.2019, pra jashte 5 viteve nga data e hapjes se ofertave.
- Per 4 (kater) punet e tjera "Sistemim + Asfaltim rruges" KVO gjykon se zerat "shtrimshtrere asfalti", "ndricim" dhe "sinjalistike" nuk mund te merren parasysh si pune te ngjashme pasi nuk tregojne aftesine e OE per kryerjen e tipologjise se punimeve ne prani uji per mbrojtje lumore. Gjithe zerat e tjere te preventivave te ketyre puneve jane marre parasysh si pune te ngjashme.
- Per 2 (dy) punet "Mirembajtje rutine rruge" te lidhura me ARRSH, KVO gjykon se punimet per "Rehabilitim" dhe "Emergjenca" kane zera punimesh te ngjashme me objektin e prokurimit dhe do te merren parasysh nderkohe qe punimet "Mirembajtje rutine" nuk mund te meren si pune te ngjashme pasi perfshijne zerat "riparim asfalti", "pastrim", "vijezim", "sinjalistike", "ndricim" dhe "mirembajtje vepra arti"te cilat nuk tregojne aftesine e OE per kryerjen e tipologjise se punimeve ne prani uji per mbrojtje lumore.

- Per 6(gjashte) punet qe jane ne perputhje me objektin e prokurimit jane marre parasysh te gjithë zerat e preventivit.

Vlera totale e zerave te punimeve qe jane marre parasysh si te ngjashme me punimet e mbrojtjes lumore per 11 kontratat vlefshme paraqitur nga OE eshte 109.620.046 lek pa tvsh, nderkohe qe sipas % te vendosur ne kontraten e bashkepunimit, OE ka (56%) te punimeve dhe duhet te arrihet vlera prej 114.800.000, sipas kerkesave te pikes b), nderkohe qe asnje pune ne vecanti nuk arrin vleren e kerkuar ne piken a).

Sipas legjistacionit duhet te plotesohen keto elemente (i) objekti i përfunduar i kontratës duhet të jenë brenda afatit (elementi kohë), (ii) duhet të plotesojnë madhësinë e kërkuar nga autoriteti kontraktor (elementi vlerë) dhe (iii) duhet të jenë të ngjashme me objektin që prokurohet (elementi natyrë e ngjashme). Mungesa qoftë edhe një prej ketyre elementëve e bën të pavlefshëm eksperiencën e ngjashme të paraqitur nga kandidati ofertues. (Referuar Vendimit Nr 1011/2023 te KPP)

- BOE nuk plotëson kerkesat e pikes 2.3.2 te “*Aftesise teknike dhe profesionale*” ku kerkohet: “*Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt i kontrates qe prokurohet, të lëshuar nga Ministria e Infrastruktures dhe Energjise, ne baze te VKM nr. 42 datë 16.01.2008, të ndryshuar, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme*” :

Për punimet e përgjithshme të ndërtimit:

N.P - 9 C Punime dhe mbrojtje lumore sistemime hidraulike dhe bonifikime.

OE “Deha 2010” shpk ne Licensen NZ. 6871/3 kategorine per N.P – 9 e ka A. Ne baze te kontrates se bashkepunimit midis OE ky i fundit ka marre persiper te kryeje 44% te punimeve ose punime ne vleren e 29.189.307 lek pa tvsh. Vlera e punimeve qe perfshin kategoria N.P – 9 “*Punime dhe mbrojtje lumore sistemime hidraulike dhe bonifikime*” kap vleren e 25.724.517 lek pa tvsh, qe sipas percaktimeve te VKM nr 42 per kete vlere punimesh duhet qe kategoria N.P – 9 te jete B (21 – 50 mil lek)

Referuar nenit 88 pika 3 të VKM-se Nr. 285 datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” i ndryshuar, parashikohet se: “*Secili prej anëtarëve të bashkimit të operatoreve duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje, si dhe nisur nga kontrata e bashkepunimit ku OE “DEHA 2010” sh.p.k ka marre persiper 44% te gjithë zerave te punimeve, kjo pike duhej te plotesohej nga ky OE sipas percaktimeve ligjore. (Referuar Vendimit 1129/2022 date 22.11.2022 te KPP)*

- BOE nuk plotëson kerkesat e pikes 2.3.3 te “*Aftesise teknike dhe profesionale*” ku kerkohet: “*Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor, drejtues teknikë licencën e shoqërisë ofertuese, si më poshtë: ”...* Drejtuesit teknik duhet të jenë të punësuar sipas kriterëve të VKM nr. 42 date 16.01.2008, i ndryshuar, “*Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi*”, pika 2 ku përcaktohen papajtuëshmëritë me detyrën e drejtuesit teknik të shoqërisë së zbatimit, per sa i takon ndalimeve të dypunësimit, si dhe ne piken a) eshte kerkuar qe “*Përgjegjësi /Drejtuesi Teknik i*

*Kantierit, i deklaruar duhet të plotësojë kriteret e përcaktuara në Udhëzimin nr. 2, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”*

BOE nuk plotëson kriteret e kesaj pike pasi pergjegjesi teknik i kantierit i deklaruar nga OE “Deha 2010” shpk nuk është sipas kerkesave ne DST. Nga verifikimet e AK, drejtuesi /pergjegjesi teknik i kantierit me inicialet F.H figuron i dypunesuar (Bashkia Tirane).

Referuar VKM-se Nr. 42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, pika 2 ku përcaktohen papajtueshmëritë me detyrën e drejtuesit teknik të shoqërisë së zbatimit, percaktohet se: Drejtuesit teknikë të shoqërisë nuk mund të jenë personat që janë të angazhuar në çdo punë-marrje tjetër publike. Referuar Udhëzimit nr. 2, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit” Kreu I, pika 2 percaktohet se : “Detyra e drejtuesit teknik të kantierit është e papajtueshme me çdo punëmarrje tjetër, publike a private, jashtë subjektit sipërmarrës. Për vepra me vlerë të plotë, të preventuar mbi 30 000 000 (tridhjetë milionë) lekë, përgjegjësi teknik i kantierit është rezident, me kohë pune të plotë në objekt dhe i diplomuar në Inxhinieri Ndërtimi”. (Referuar Vendimit 477 date 23.10.2020 te KPP).

- BOE nuk plotëson kerkesat e pikes 2.3.4 te “Aftesise teknike dhe profesionale”ku kerkohet: “Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar për kryerjen e punimeve, te cilet duhet te jene te pajisur me Certifikata/diploma për formimin profesional (të vlefshme), të lëshuara nga institucione publike/private të licensuara sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në R.Sh. ”, i ndryshuar, sipas profileve te më poshtëme”

- Specialist ndertimi - murator 15 (pesembedhete)

Gjate fazes se ofertimit, në plotësimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit (shtojca 8), ne pika B. - Deklarata - “Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate”, operatorët ekonomik per punonjesit e mesiperm duhet të deklarojnë: emer/mbiemer, profilin e punes, subjektin leshues te certefikates/diplomes, Nipt (ne rastin kur subjekti leshues i certifikates/diplomes eshte privat).

Nga OE “Rroku GUEST” sh.p.k është deklaruar se punonjësit me inicialet A.U, P.M dhe L.N me profesion “Specialist ndertimi” janë të pajisur me certifikate/diplomë të lëshuar nga shoqëria “QTA” me NUIS L61325037A.

Nga verifikimi i kryer në faqen zyrtare [www.qkb.gov.al](http://www.qkb.gov.al), në seksionin “Kërko për Licence”, shoqëria si më sipër është e licencuar me licencën me nr. LN-2358-11-2016me Titull “Formim profesional” e cila është “Aktive”.

KVO i është drejtuar subjektit licensues “QTA” me shkresë Nr 222 prot date 20.05.2024 ku ka kerkuar qe te verifikohen nese certefikatat e leshuara per punojesit e mesiperm jane sipas profesionit te kerkuar ne DST dhe nese ato jane ende te vlefshme. Me shkresë Nr 222/1 prot date 21.05.2024 dhe Nr 222/2 prot date 22.05.2024 subjekti licensues shprehet se: “Punojesit e mesiperm kane kryer prane qendres sone vetem nje trajnim 5 ditor per profesionin punues guri, duke u regjistruar si pjesemares. Certefikatat e tyre jane te pavlefshme pasi punojesit nuk kane dhene provim, ju ka kaluar afati ligjor, gjithashtu keto certefikata nuk kane nje numer amze prane qendres sone”. KVO me shkresë dt 08.07.2024 i ka kerkuar serisht informacion subjektit licensues “QTA” nese keta punojes kane certifikime te tjera nga ky subjekt. Me shkresë dt 09.07.2024 subjekti licensues konfirmon se punojesi me inicialet A.U ka certefikim per profesionin “Pllakashtrues”, punojesi me inicialet P.M ka



certifikim per profesionin “Saldator” nderkohe qe punojesi me inicialet L.N ka kryer prane qendres sone vetem nje trajnim 5 ditor per profesionin punues guri, duke u regjistruar vetem si pjesemares. Per sa me sipër punojësit e deklaruar nga OE si “Specialiste ndertimi - murator” nuk jane te pajisur me Certifikata/diploma për formimin profesional (të vlefshme), të lëshuara nga institucione publike/private të licensuara sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në R.Sh.”, sipas profilit të kërkuar në DST. (Referuar Vendimit 238/2021 të KPP)

- BOE nuk plotëson kërkesat e pikes 2.3.5 të “Aftësisë teknike dhe profesionale” ku kërkohe: “Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të kualifikuar për kryerjen e punimeve, të cilet duhet të jene te pajisur me Dëshmi të Aftësisë Profesionale, që të vërtetojë kualifikimin profesional, sipas profileve të më poshtëme”:

- Shofer kamjoni 11 (njembëdhjete)
- Punojës të thjeshtë ndertimi 15 (pesembëdhjete)

Gjate fazes se ofertimit, në plotësimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit (shtojca 8), në pika B. - Deklarata - “Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate”, operatorët ekonomik per punonjësit eskavatoriste/manovrator, automakiniste, buldozierist dhe shofer kamjoni, duhet të deklarojnë: emer/mbiemer, profilin e punes, numrin e deshmise së aftësisë profesionale dhe datën e vlefshmerise se saj, nderkohe qe per punojësit e thjeshte te ndertimit: emer/mbiemer dhe Nr e kontrates se punes.

OE “Rroku GUEST” sh.p.k ka paraqitur 5 (pese) shofere nga 6 (gjashte) qe duhet te paraqiste sipas akt marveshjes per bashkepunim ku ka marre persiper 56% te punimeve nderkohe qe nuk ka paraqitur asnje punojës të thjeshtë ndertimi.

Referuar nenit 88 pika 3 të VKM-se Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: “Secili prej anëtarëve të bashkimit të operatoreve duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje, si dhe nisur nga kontrata e bashkepunimit ku OE “Rroku GUEST” sh.p.k ka marre persiper 56% te gjithe zerave te punimeve, kjo pike duhej te plotesohej edhe nga ky OE sipas kërkesave ne DST. (Referuar Vendimit 1129/2022 date 22.11.2022 të KPP)

- BOE nuk plotëson kërkesat e pikes 2.3.8 të “Aftësisë teknike dhe profesionale” ku kërkohe: “Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme”

- Mjet teknologjik me goma (Dumper) – 2 cop.

Mjetet e paraqitura nga BOE nuk jane sipas kërkesave ne DST, pasi jane deklaruar pa targa.

Referuar nenit 47 “Klasifikimi i mjeteve rrugore” pika 1, e ligjit Nr. 8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, parashikohet: 1. “Mjetet, sipas qëllimeve të përcaktuara në këtë Kod”, klasifikohen si vijon:

- k) mjete teknologjike

Ne nenin 58, pika 1 dhe 2, parashikohet: 1. “Mjetet teknologjike janë makina vetëlëvizëse ose që tërhiqen, me rrota ose me zinxhirë”. 2. “Sipas qëllimeve të qarkullimit rrugor, mjetet teknologjike ndahen në: a) mjete që përdoren për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e veprave ndërtimore a të infrastrukturës rrugore ose për rivendosjen e trafikut”

Ndërsa në nenin 113 pika 2 e këtij ligji parashikohet: “Për të qarkulluar në rrugë mjetet teknologjike me goma, duhen regjistruar në zyrat e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, që i lëshojnë lejen e qarkullimit atij që vërteton se është pronari i mjetit”. Në VKM Nr.153 datë 07.04.2000 “Për Miratimin e Rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, në nenin 282 “Regjistrimi dhe vendosja e targës e makinave (Neni 113 i Kodit Rrugor)”, pika 1, parashikohet: “Makinat, te cilat lejohen të qarkullojnë ne rruge sipas nenit 113 të Kodit Rrugor, duhet të regjistrohen prane deges se DRShTRr-se rrethit përkatës, që merret me nxjerrjen e lejes se qarkullimit dhe të targes të atij që deklarohet pronar i mjetit.”

Referuar pikës 4, të nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, si dhe kreut V, seksioni III, neni 39, pika 6, germa ”d” të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku citohet: AK kerkon mjetet e pajisjet teknike, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën” si dhe bazuar ne percaktimet ligjore te ligjit Nr. 8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Njesia e Prokurimit eshte shprehur qartazi ne kerkesat e DST per llojin e mjetit qe kerkon, ne menyre qe plotesimi i kesaj pike te mos jete konfuze per OE. (Referuar Vendimit 225/2023 te KPP)

- BOE nuk plotëson pikën 2.4.1 të “Kerkesa te tjera te vecanta per kualifikim” ku kërkohet: “Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se e zhvillojnë aktivitetin e tij në fushën objekt prokurimi në përputhje me standardet e menaxhimit të cilësisë, të shëndetit e sigurisë në punë dhe mjedisit. Për këtë duhet të paraqesin certifikatat e mëposhtme”

- Leje Mjedisore lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit për “Grumbullim dhe transportim të mbetjeve” me Kod III.2.B.

Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zërave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes.

OE “Rroku GUEST” sh.p.k nuk ka paraqitur certifikaten e mesiperme.

Referuar nenit 88 pika 3 të VKM-se Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: “Secili prej anëtarëve të bashkimit te operatoreve duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje, si dhe nisur nga kontrata e bashkepunimit ku OE “Rroku GUEST” sh.p.k ka marre persiper 56% te gjithe zerave te punimeve, perfshi ketu dhe punime germimi, kjo pike duhet te plotesohej edhe nga ky OE. (Referuar Vendimit 1129/2022 date 22.11.2022 te KPP)

Në rast se bashkimi i operatorëve ekonomikë do të kishte paqartësi në lidhje me plotësimin e kërkesave të mësipërme, ka pasur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në 6 ditë para afatit perfundimtar te dorëzimit të ofertave

parashikuar nga neni 75 i LPP-së, i ndryshuar. Është detyrë e operatorëve ekonomikë të përgatisin ofertat e tyre në përputhje me kriteret ligjore në fuqi dhe me kushtet e vendosura nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit për sa kohë që i kanë pranuar ato dhe nuk i kanë bërë në asnjë rast objekt-ankimimi.

Në bazë të ligjit 162/2020 “Per Prokurimin Publik” i ndryshuar, Neni 92, pika 3, - “Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit”, KVO vendos se për arsyet e mesipërme ky subjekt: skualifikohet.

3. OE “VELLEZERIT HYSA” shpk, me NUIS K12911201C, me ofertë ekonomike: 74.167.002 (shtatedhjetë e katër milion e njëqind e gjashtedhjetë e shtate mije e dy) lekë pa tvsh.

- OE nuk plotëson kërkesat e pikës 2.3.3 të “Aftësisë teknike dhe profesionale” ku kërkohej: “Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor, drejtues teknikë licencën e shoqërisë ofertuese, si më poshtë”:
  - Inxhinier Hidroteknik - 1 (nje)
  - Inxhinier Topograf - 1 (nje)
  - Inxhinier Gjeoteknik - 1 (nje)

Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe stafin mbështetës (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë:

- Inxhinier Hidroteknik - 1 (nje)
- Inxhinier Mjedisi - 1 (nje)
- Inxhinier Ndertimi (Profili – Gjeoteknik - 1 (nje)

Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij 1(një) punonjës të trajnuar dhe të certifikuar për “Punime në prani uji”, lëshuar nga një organizëm çertifikimi i pavarur i njohur nga sistemet e standartizimit kombëtar ose ndërkombëtar dhe i regjistruar pranë drejtorisë së akreditimit në ME në Republikën e Shqipërisë, shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplome/certifikate, Libreze pune si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi 3 (tre) muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave.

OE nuk ka paraqitur :

- 1 (nje) Inxhinier Gjeoteknik
- 1 (nje) Inxhinier Hidroteknik (nga 2 te kerkuar)
- 1 (nje) Inxhinier Ndertimi (Profili – Gjeoteknik)
- 1 (nje) Punojës të certifikuar për “Punime në prani uji”
- OE nuk plotëson kërkesat e pikës 2.3.3 të “Aftësisë teknike dhe profesionale” pika a), ku kërkohej: “Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë nga Administratori i shoqërisë, Përgjegjës/Drejtnuesin Teknik të Kantierit, i cili do të sigurojë drejtimin teknik të punimeve në kantier dhe nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera. Përgjegjësi Teknik i Kantierit, i deklaruar duhet të plotësojë kriteret e përcaktuara në Udhëzimin nr. 2, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”.

OE ka deklaruar se Pergjegjes Teknik ne Kantier do te jete inxhinieri me inicialet O.B Inxhinieri i mesiperm eshte deklaruar ne formularin e vetedeklarimit si *Inxhinier Hidroteknik*. Nderkohe qe sipas kerkeses ne DST, Pergjegjesi Teknik i Kantierit i deklaruar, duhet te plotësojë kriteret e përcaktuara në Udhëzimin nr. 2, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”. Referuar Kreut I/2.1 të Udhëzimit nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit” përcaktohet se “Drejtimi teknik i punimeve në kantier sigurohet, sipas rastit, drejtpërdrejt nga drejtuesi teknik i sipërmarrësit ose përgjegjësi teknik i kantierit. Për vepra me vlerë të plotë, të preventuar mbi 30 000 000 (tridhjetë milionë) lekë, përgjegjësi teknik i kantierit është rezident, me kohë pune të plotë në objekt dhe i diplomuar në Inxhinieri Ndërtimi”.

Vlera e ketij investimi e kalon vleren prej 30 milion lekesh te parashikuar si prag ne Udhëzimin e sipercituar, per keto arsye Pergjegjes Teknik ne Kantier i deklaruar nga OE nuk i permbush kerkesat e DST.

- OE nuk plotëson kerkesat e pikes 2.3.4 te “Aftesise teknike dhe profesionale”ku kerkohet: “Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar për kryerjen e punimeve, te cilet duhet te jene te pajisur me Certifikata/diploma për formimin profesional (të vlefshme), të lëshuara nga institucione publike/private të licensuara sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në R.Sh.”, i ndryshuar, sipas profileve te më poshtëme”:

- Teknik i mesem hidroteknik	1 (nje)
- Teknik i mesem ndertimi	1 (nje)
- Specialist ndertimi - murator	15 (pesembedhjete)
- Karpentier	2 (dy)
- Hekurkthyes	2 (dy)

Gjate fazes se ofertimit, në plotësimin e formularit përmbledhës të vetedeklarimit (shtojca 8), ne pika B. - Deklarata - “Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate”, operatorët ekonomik per punonjesit e mesiperm duhet të deklarojnë: emer/mbiemer, profilin e punes, subjektin leshues te certifikates/diplomes, Nipt (ne rastin kur subjekti leshues i certifikates/diplomes eshte privat).

OE ka deklaruar gjithesej 16 (gjashtembedhjete) punojes me specifikimet e mesiperme nga 21 (njezet e nje) te kerkuar ne DST.

- OE nuk plotëson kerkesat e pikes 2.3.5 te “Aftesise teknike dhe profesionale” ku kerkohet: “Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të kualifikuar për kryerjen e punimeve, te cilet duhet te jene te pajisur me Dëshmi te Aftesise Profesionale, që të vërtetojë kualifikimin profesional, sipas profileve te më poshtëme”:

- Buldozierist	2 (dy)
- Punojes te thjeshte ndertimi	15 (pesembedhjete)

Gjate fazes se ofertimit, në plotësimin e formularit përmbledhës të vetedeklarimit (shtojca 8), ne pika B. - Deklarata - “Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate”, operatorët ekonomik per punonjesit eskavatoriste/manovrator, automakiniste, buldozierist dhe shofer kamjoni, duhet të deklarojnë: emer/mbiemer, profilin e punes, numrin e deshmise së aftësisë profesionale dhe daten e vlefshmerise se saj, nderkohe qe per punojesit e thjeshte te ndertimit: emer/mbiemer dhe Nr e kontrates se punes.

OE nuk ka paraqitur asnje nga punojesit e mesiperm sipas kerkesave ne DST.

- OE nuk plotëson kerkesat e pikes 2.3.8 te “Aftesise teknike dhe profesionale”ku kerkohet: “Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme”
  - Mjet teknologjik me goma (Dumper) – 2 cop.
  - Mjet teknologjik me goma (Grejder) – 1 cop

Mjetet e paraqitura nga OE nuk jane sipas kerkesave ne DST, pasi jane deklaruar pa targa.

Referuar nenit 47 “Klasifikimi i mjeteve rrugore” pika 1, e ligjit Nr. 8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, parashikohet: 1. “Mjetet, sipas qëllimeve të përcaktuara në këtë Kod”, klasifikohen si vijon:

k) mjete teknologjike

Ne nenin 58, pika 1 dhe 2, parashikohet: 1. “Mjetet teknologjike janë makina vetëlëvizëse ose që tërhiqen, me rrota ose me zinxhirë”. 2. “Sipas qëllimeve të qarkullimit rrugor, mjetet teknologjike ndahen në: a) mjete që përdoren për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e veprave ndërtimore a të infrastrukturës rrugore ose për rivendosijen e trafikut”

Ndërsa në nenin 113 pika 2 e këtij ligji parashikohet: “Për të qarkulluar në rrugë mjetet teknologjike me goma, duhen regjistruar në zyrat e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, që i lëshojnë lejen e qarkullimit atij që vërteton se është pronari i mjetit”. Në VKM Nr.153 datë 07.04.2000 “Për Miratimin e Rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, në nenin 282 “Regjistrimi dhe vendosja e targës e makinave (Neni 113 i Kodit Rrugor)”, pika 1, parashikohet: “Makinat, te cilat lejohen të qarkullojnë ne rruge sipas nenit 113 të Kodit Rrugor, duhet të regjistrohen prane deges se DRShTRr-se rrethit përkatës, që merret me nxjerrjen e lejes se qarkullimit dhe të targes të atij që deklarohet pronar i mjetit.”

Referuar pikës 4, të nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, si dhe kreut V, seksioni III, neni 39, pika 6, germa ”d” të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku citohet: AK kerkon mjetet e pajisjet teknike, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën” si dhe bazuar ne percaktimet ligjore te ligjit Nr. 8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Njesia e Prokurimit eshte shprehur qartazi ne kerkesat e DST per llojin e mjetit qe kerkon, ne menyre qe plotesimi i kesaj pike te mos jete konfuze per OE. (Referuar Vendimit 225/2023 te KPP)

Në rast se operatori ekonomik do të kishte paqartësi në lidhje me plotësimin e kërkesave të mësipërme, ka pasur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në 6 ditë para afatit perfundimtar te dorëzimit të ofertave parashikuar nga neni 75 i LPP-së, i ndryshuar. Eshtë detyrë e operatorëve ekonomikë të përgatisin ofertat e tyre në përputhje me kriteret ligjore ne fuqi dhe me kushtet e vendosura nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit për sa kohë që i kanë pranuar ato dhe nuk i kanë bërë në asnjë rast objekt-ankimimi.

Ne baze te ligjit 162/2020 “Per Prokurimin Publik” i ndryshuar, Neni 92, pika 3, - “Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha

kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit”, KVO vendos se per arsyet e mesiperme ky subjekt: skualifikohet.

4. OE “STERKAJ” shpk, me NUIS J68310708M, me ofertë ekonomike: 74.949.262,5 (shtatedhete e kater milion e nenteqind e dyzet e nente mije e dyqind e gjashtedhete e dy presje pesë) lekë pa tvsh.
- OE nuk plotëson kerkesat e pikes 2.3.3 te “Aftesise teknike dhe profesionale” ku kerkohet: “Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor, drejtues teknikë licencën e shoqërisë ofertuese, si më poshtë”:
    - Inxhinier Hidroteknik - 1 (nje)
    - Inxhinier Topograf - 1 (nje)
    - Inxhinier Gjeoteknik - 1 (nje)

Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe stafin mbështetës (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë:

- Inxhinier Hidroteknik - 1 (nje)
- Inxhinier Mjedisi - 1 (nje)
- Inxhinier Ndertimi (Profili – Gjeoteknik - 1 (nje)

Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij 1(një) punonjës të trajnuar dhe të certifikuar për “Punime në prani uji”, lëshuar nga një organizëm çertifikimi i pavarur i njohur nga sistemet e standartizimit kombëtar ose ndërkombëtar dhe i regjistruar pranë drejtorisë së akreditimit në ME në Republikën e Shqipërisë, shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplome/certifikate, Libreze pune si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi 3 (tre) muajt e fundit nga data e hapjes se ofertave.

OE nuk ka paraqitur :

- 1 (nje) Inxhinier Gjeoteknik (Inxhinieri i paraqitur nga OE eshte Gjeolog)
- 1 (nje) Inxhinier Ndertimi (Profili – Gjeoteknik)
- 1 (nje) Punojes te certifikuar per “Punime në prani uji”

- OE nuk plotëson kerkesat e pikes 2.3.5 te “Aftesise teknike dhe profesionale” ku kerkohet: “Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të kualifikuar për kryerjen e punimeve, te cilet duhet te jene te pajisur me Dëshmi te Aftesise Profesionale, që të vërtetojë kualifikimin profesional, sipas profileve te më poshtëme”:

- Buldozierist 2 (dy)
- Manovratore/eskavatoriste 5 (pese)

Gjate fazes se ofertimit, në plotësimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit (shtojca 8), ne pika B. - Deklarata - “Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate”, operatorët ekonomik per punonjesit eskavatoriste/manovrator, automakiniste, buldozierist dhe shofer kamjoni, duhet të deklarojnë: emer/mbiemer, profilin e punes, numrin e deshmise së aftësisë profesionale dhe daten e vlefshmerise se saj, nderkohe qe per punojesit e thjeshte te ndertimit: emer/mbiemer dhe Nr e kontrates se punes.

OE nuk ka deklaruar asnje punojës të kualifikuar si “*Buldozierist*” nderkohe që ka paraqitur vetëm 2 (dy) punojës të kualifikuar si “*Manovratorë/eskavatoristë*” nga 5 (pese) sipas kërkesave në DST. Për keta të fundit OE ka deklaruar se ka lidhur një kontratë qeraje midis tij dhe OE “Babasi CO” shpk në të cilën citohet se mjetet e marra me qera do të drejtohen nga punojësit e këtij OE, duke paraqitur kështu dhe 3 (tre) eskavatoristë të tjerë për të plotësuar numurin e kërkuar në DST. AK në DST ka saktësuar se: “*Kur mjetet janë marrë me qira nga persona fizik, të cilat janë në pronësi të këtyre të fundit, atëherë manovratorët, automakinistët dhe shoferët nuk ka nevojë që të figurojnë në listëpagesat përkatëse të O.E. ofertues*” OE “Sterkaj” shpk në Formularin e vetedeklarimit sipas Shtojcës 8 nuk ka deklaruar asnje mjet të rende (eskavator, buldozier etj) të marre me qera për plotësimin e kërkesave të DST. Në këtë rast OE mund ta deklaronte OE “Babasi CO” si Subjekt Mbeshtetës duke plotësuar kërkesat ligjore për këtë procedurë, por nuk mund të deklarojë punojës të cilët drejtojnë mjete të cilat nuk janë marre me qera për këtë objekt prokurimi.

- OE nuk plotëson kërkesat e pikës 2.3.8 të “*Aftësisë teknike dhe profesionale*” ku kërkohe: “*Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme*”
  - *Mjet teknologjik me goma (Dumper) – 2 cop.*
  - *Mjet teknologjik me goma (Grejder) – 1 cop*
  - *Kamjon vetëshkarkues me kapacitet jo më të vogël se 10 t – 6 cop.*

OE ka paraqitur vetëm 3 (tre) Kamjone me kapacitet jo më pak se 10 t nga 6 (gjashtë) të kërkuar në DST, nderkohe që kamjonet me kapacitet jo më pak se 20 t janë deklaruar 4 (kater) sa është kërkesa në DST. Mjetet e tjera (Dumper & Grejder) të paraqitura nga OE nuk janë sipas kërkesave në DST, pasi janë deklaruar pa targa.

Referuar nenit 47 “*Klasifikimi i mjeteve rrugore*” pika 1, e ligjit Nr. 8378, datë 22.07.1998 “*Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë*”, i ndryshuar, parashikohet: 1. “*Mjetet, sipas qëllimeve të përcaktuara në këtë Kod*”, klasifikohen si vijon:

*k) mjete teknologjike*

Në nenin 58, pika 1 dhe 2, parashikohet: 1. “*Mjetet teknologjike janë makina vetëlëvizëse ose që tërhiqen, me rrota ose me zinxhirë*”. 2. “*Sipas qëllimeve të qarkullimit rrugor, mjetet teknologjike ndahen në: a) mjete që përdoren për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e veprave ndërtimore a të infrastrukturës rrugore ose për rivendosjen e trafikut*”

Ndërsa në nenin 113 pika 2 e këtij ligji parashikohet: “*Për të qarkulluar në rrugë mjete teknologjike me goma, duhen regjistruar në zyrat e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, që i lëshojnë lejen e qarkullimit atij që vërteton se është pronari i mjetit*”. Në VKM Nr.153 datë 07.04.2000 “*Për Miratimin e Rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë*”, të ndryshuar, në nenin 282 “*Regjistrimi dhe vendosja e targës e makinave (Neni 113 i Kodit Rrugor)*”, pika 1, parashikohet: “*Makinat, të cilat lejohen të qarkullojnë në rrugë sipas nenit 113 të Kodit Rrugor, duhet të regjistrohen prane degës së DRShTRr-se rrethit përkatës, që merret me nxjerrjen e lejes së qarkullimit dhe të targës të atij që deklarohet pronar i mjetit.*”

Referuar pikës 4, të nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “*Për Prokurimin Publik*” i ndryshuar, si dhe kreut V, seksioni III, neni 39, pika 6, germa ”d” të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” ku citohet: AK kërkon mjetet e pajisjet

teknike, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën” si dhe bazuar ne percaktimet ligjore te ligjit Nr. 8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Njesia e Prokurimit është shprehur qartazi ne kerkesat e DST per llojin e mjetit qe kerkon, ne menyre qe plotesimi i kesaj pike te mos jete konfuze per OE. (Referuar Vendimit 225/2023 te KPP)

Në rast se operatori ekonomik do të kishte paqartësi në lidhje me plotësimin e kërkesave të mësipërme, ka pasur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në 6 ditë para afatit perfundimtar te dorëzimit të ofertave parashikuar nga neni 75 i LPP-së, i ndryshuar. Është detyrë e operatorëve ekonomikë të përgatisin ofertat e tyre në përputhje me kriteret ligjore ne fuqi dhe me kushtet e vendosura nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit për sa kohë që i kanë pranuar ato dhe nuk i kanë bërë në asnjë rast objekt-ankimimi.

Ne baze te ligjit 162/2020 “Per Prokurimin Publik” i ndryshuar, Neni 92, pika 3, - “Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit”, KVO vendos se per arsyet e mesiperme ky subjekt: skualifikohet.

5. OE “SHKELQIMI 07” shpk, me NUIS K68121808W, me ofertë ekonomike: 85.383.407 (tetedhjetë e pese milion e treqind e tetedhjetë e tre mijë e katerqind e shtate) lekë pa tvsh.

OE ka mangesi te thekesuara ne plotesimin e kerkesave te DST, si me poshte:

- Mungon Sigurimi i Ofertes
- Mungojne Bilancet e te tre viteve
- Puna e ngjashme nuk arrin vleren e kerkuar ne DST
- Mungon Inxh Gjeoteknik
- Mungon Inxh Hidroteknik (1 nga 2 te kerkuar)
- Mungon Inxh Mjedisit
- Mungon Inxh Ndertimit (Profil Gjeoteknik)
- Mungon Mjeku
- Pergjegjesi i kantierit i deklaruar Inxh Hidroteknik (duhet Inxh Ndertimi)
- Mungon punojesi i certifikuar “Punime ne prezence uji”
- Mungojne ne numurin total punojes te specializuar + Kualifikuar
- Mungon Grafiku i firmosur
- Mungojne mjete dhe paisje
- Mungon autorizim per beton+inerte+rrjete teli
- Mungon deklarata e dakortesise per financimin

Në rast se operatori ekonomik do të kishte paqartësi në lidhje me plotësimin e kërkesave të mësipërme, ka pasur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në 6 ditë para afatit perfundimtar te dorëzimit të ofertave parashikuar nga neni 75 i LPP-së, i ndryshuar. Është detyrë e operatorëve ekonomikë të përgatisin ofertat e tyre në përputhje me kriteret ligjore ne fuqi dhe me kushtet e vendosura nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit për sa kohë që i kanë pranuar ato dhe nuk i kanë bërë në asnjë rast objekt-ankimimi.



Ne baze te ligjit 162/2020 “Per Prokurimin Publik” i ndryshuar, Neni 92, pika 3, - “Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit”, KVO vendos se per arsyet e mesiperme ky subjekt: skualifikohet.

1. BOE “METEO” shpk, me NUIS L26310801C, i cili mer persiper 92.3% (nentedhjetë e dy pike tre) të vleres se punimeve dhe OE “Shendelli” shpk, me NUIS K07924803N, i cili merr persiper 7.7% (shtate pike shtate) të vleres se punimeve me ofertë ekonomike: 74.924.115 (shtatëdhjetë e katër milion e nëntëqind e njëzet e katër mijë e njëqind e pesëmbëdhjetë) lekë pa tvsh.

Ne baze te nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet që “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin” KVO me shkresë Nr. 339 prot., datë 17.07.2024, i është drejtuar OE ku i kerkohet paraqitja e dokumenteve mbështetëse në lidhje me vetëdeklarimin. Kerkesa është nisur zyrtarisht me poste ne adresen e deklaruar ne formularin e vetedeklarimit, ne rruge elektronike me email ne adresen e deklaruar ne formular (ku është konfirmuar marrja e informacionit në datën 18.07.2024) si dhe ne faqen e APP. KVO me shkresën Nr. 339 prot., datë 17.07.2024 dhe me e-mail të dates 23.07.2024, ndër të tjera OE ju bë me dije se: “Në rast të mos dorezimit te dokumentacionit te kerkuar, brenda 5(pesë) ditëve nga marrja e njoftimit, oferta juaj do të refuzohet”.

Nisur nga fakti se OE nuk ka kthyer asnjë përgjigje, oferta e tij refuzohet.

Ne baze te ligjit 162/2020 “Per Prokurimin Publik”, Neni 92, pika 3, - “Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit”, KVO vendos se per arsyet e mesiperme ky subjekt: skualifikohet.

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se : BOE “SALILLARI” shpk Tiranë, me adresë: Berat Ura Vajgurore, Lagjia 4 Shtatori , nr Pasurie 1/28, Zona Kadastrale nr. 3682, Ura Vajgurore, Dimal (Ish Magazinat ), perballe Komisarariatit te Policise Ura Vajgurore, Bashkia Dimal & OE “Z D R A V A” shpk Lushnjë, me adresë: Fier Lushnje, Autostrada Lushnje-Fier km 4, Pasuria me nr 104/18 në zonën kadastrale 3268/9001, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej : 78.274.050,89 (shtatedhjetë e tete milion e dyqind e shtatedhjetë e kater mije e pesedhjetë presje tetedhjetë e nente) lekë pa tvsh, / totali i pikëve të marra [\_\_\_\_\_]është identifikuar si fitues (paraprak) i procedurës së prokurimit.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.

**UJËSJELLËS-KANALIZIME KAMËZ SH.A**

Drejtuar: BOE "EVEREST" shpk & "2 T" shpk me nr Nipt: J78311921L & K01731001M

Adresa: Tirane, Kamez Fabrika ne Rrugen Nacionale, Prane Nyjes se Betonit

Procedura e prokurimit/lotit: " Procedurë E Hapur – Punë "

Numri i procedurës / referenca e Lotit: REF-09519-06-14-2024

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: "Rrjeti shperndares I furnizimit me uje dhe te KUZ te zones se Fruti Kultures, Valias I Vjetër, Bashkia Kamëz"

Fondi limit: 508 336 290 (pesëqind e tetë milion e treqind e tridhjetë e gjashtë mijë e dyqind e nëntëdhjetë) lekë pa TVSH.

Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj: 12 (dymbëdhjetë) muaj nga data e dorëzimit të sheshit të ndërtimit.

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim  X

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. ALBA KONSTRUKSION shpk

J61812013R

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-t

Vlera: 426,562,584 (Katërqind e njëzet e gjashtë milion e pesëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e pesëqind e tetëdhjetë e katër ) leke pa tvsh  
(e shprehur në shifra dhe fjalë)

2. LIS KONSTRUKSION shpk & VIANTE Konstruksion shpk K66613407H & K47103804L

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-t

Vlera: 431,086,304.25 (Katërqind e tridhjetë e një mijë e tetëdhjetë e gjashtë mijë e treqind e katër pike njëzet e pesë ) leke pa tvsh  
(e shprehur në shifra dhe fjalë)

3. "EVEREST" shpk & "2 T" shpk

J78311921L & K01731001M

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-t

Vlera: 495,914,580 (Katërqind e nëntëdhjetë e pesë milion e nëntëqind e katërmëdhjetë mijë e pesëqind e tetëdhjetë ) leke pa tvsh  
(e shprehur në shifra dhe fjalë)

4. ALMO KONSTRUKSION shpk

J91915001P

*Emri i plotë i shoqërisë* *Numri i NIPT-t*  
Vlera: 505,627,600 (Pesëqind e pesë milion e gjashtëqind e njëzet e shtatë mijë e gjashtëqind ) leke pa tvsh  
(e shprehur në shifra dhe fjalë)

5. KRONOS KONSTRUKSION shpk *Numri i NIPT-t*  
*Emri i plotë i shoqërisë* K41416033P  
Vlera: 501,529,905 (Pesëqind e një milion e pesëqind e njëzet e nëntë mijë e nëntëqind e pesë ) leke pa tvsh  
(e shprehur në shifra dhe fjalë)

6. SALILLARI shpk *Numri i NIPT-t*  
*Emri i plotë i shoqërisë* J62903125G  
Vlera: 499,799,548.50 (Katërqind e nëntëdhjetë e nëntë milion e shtatëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e pesëqind e dyzet e tetë pikë pesëdhjetë ) leke pa tvsh  
(e shprehur në shifra dhe fjalë)

7. SHANSI INVEST shpk *Numri i NIPT-t*  
*Emri i plotë i shoqërisë* J61924002T  
Vlera: 507,666,222 (Pesëqind e shtatë milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e dyqind e njëzet e dy) leke pa tvsh  
(e shprehur në shifra dhe fjalë)

Etj.

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. ALBA KONSTRUKSION shpk *Numri i NIPT-t*  
*Emri i plotë i shoqërisë* J61812013R

1. Operatori Ekonomik ALBA KONSTRUKSION sh.p.k skualifikohet nga ky tender per arsyet e poshteshenuara :

1. Për kapacitetin teknik:

2.3.1 Për Listën e mallrave/ materialeve të përcaktuara në Preventivin objekt prokurimi, listën si më poshtë:

- Tuba HDPE/ PN 10 sipas dimensioneve të kërkuara në Projekt – preventivin dhe Specifikimeve teknike
- Tuba të brinjëzuar HDPE SN 8 sipas dimensioneve të kërkuara në Projekt - preventivin dhe Specifikimeve teknike

Operatori ekonomik duhet të paraqesë:

1. Autorizim të prodhuesit/ve ose nga distributor i autorizuar prej prodhuesit ose Marrëveshje bashkëpunimi (ose ekuivalenti i tij/saj) të zyrtarizuar, e cila të tregojë lidhjen midis ofertuesit

dhe prodhuesit ose midis ofertues-distributor-prodhues për listën e mësipërme të mallrave lëshuar/ lidhur jo më parë se data e publikimit të procedurës së prokurimit. Autorizimi/ Marrëveshja bashkëpunimit duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

2. Katalogun/ët ose fragmente të katalogut/ëve e prodhuesit/ve për listën e mësipërme, në të cilët të tregohen dhe të specifikohen qartë materialet që do të ofrohen.

*Shënim: Fragmentet e katalogut/ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qartë që janë pjesë katalogu, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i përkasin.*

3. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë dëshmi të testimeve zyrtare të kryera, të lëshuara nga institucione të autorizuara ose nga prodhuesi, që vërtetojnë pajtueshmërinë e materialeve të prodhuara (lista e mësipërme) me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara

- ❖ Pas verifikimit të dokumentacionit të paraqitur në SPE shifet që nuk keni paraqitur dëshmi të testimeve zyrtare pasi certifikata e konformitetit e paraqitur ka përfunduar afatin e saj me datë 19 Nentor të vitit 2023 si dhe ky dokumentacion për plotësimin e kësaj pike është në gjuhë të huaj në kundërshtim me kriterin pikën 2.7 të dokumentave standarte të tenderit ku parashikohet si me poshtë vijon :

4.7 Gjuha (ët) në të cilat mund të hartohen ofertat:

Shqip  Anglisht

Në rast se Operatorët Ekonomikë do të paraqesin dokumentacion në gjuhë të huaj, dokumentat duhet të përkthehen në shqip dhe të noterizohen.

Paraqitja e dokumentacionit në gjuhë të huaj e ben te pamundur identifikimin e plotësimit të kriterit mbi dëshmi të testeve zyrtare sipas përcaktimeve të autoritetit kontraktor në dokumentat e tenderit.

Në kushtet kur, në dokumentat e tenderit të hartuara e të miratuara nga Agjencia e Prokurimit Publik, e konkretisht në kriteret e përgjithshme, të cilat janë detyrues për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë, si dhe detyrues për të mos u ndryshuar nga autoriteti kontraktor gjatë hartimit të dokumentave të tenderit, është përcaktuar qartë e saktë që "Nëse gjuha e përdorur në procedurë është shqip, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe", si edhe gjuha e përdorur është përcaktuar "Gjuha Shqipe", atëherë i gjithë dokumentacioni i paraqitur në procedurën e prokurimit duhet të jetë në gjuhën shqipe ose i përkthyer i noterizuar në gjuhën shqipe, përcaktim ky gjithpërfshirës që i përket çdo lloj dokumentacioni që do të paraqitet në këtë procedurë prokurimi nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës.

Praktika të ngjashme të ndjekura nga KPP ne vite si vendimi nr K.P.P. 254/2018 , 26.04.2018, vendimi V E N D I M Nr. 1287 /2023 faqa 18.

Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

Autoriteti kontraktor duhet të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit.

### 2.3.8 Makineri, Pajisje)

- a) Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, automjetet dhe pajisjet (sipas tabelës) të cilat duhet të jenë në pronësi të tij ose me qira të vërtetuara këto me dokumentacionin përkatës;

Nr.	Përshkrimi i Automjetit/ mjetit/ Pajisjes	Sasia
1.	Kamiona vetshkarkues me kapaciteti mbajtës mbi 20 ton per secilin kamion	<i>jo më pak se 2 copë</i>
2.	Kamiona vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 10 -20 ton	<i>jo më pak se 3 copë</i>
3.	Kamiona vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 5 -10 ton	<i>jo më pak se 3 copë</i>
4.	Kamion/ Kamionçinë me kapacitet mbajtës deri 3.5 ton	<i>jo më pak se 3 copë</i>
5.	Kamion me Vinç me kapacitet mbajtës minimumi 7 ton	<i>jo më pak se 2 copë</i>

- ❖ Ky kush nuk permbushet nga operatori ekonomik “ALBA KONSTRUKSION” pasi nga 3(tre) kamion vetshkarkues 10-20 ton ka paraqitur vetëm 2(dy). Operatori ka deklaruar 4(katër) kamiona vetshkarkues me kapacitet 5-10 ton nga 3(tre) te kerkuar po kjo nuk ploteson tonazhin e kerkuar nga AK.

Sa me siper Komisioni i Vleresimit te Ofertave mbeshtetur nenin 77, pika 1, 4 dhe 5, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve, si dhe në nenin 92, pika 3 të

ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”, vendosi të refuzojë ofertën e OE “ALBA KONSTRUKSION” SH.P.K, për mos përmbushje të kriterëve të vecanta kualifikuese.

Si përfundim, në mbështetje të nenit 92, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, OE “ALBA KONSTRUKSION” SH.P.K, *skualifikohet*.

## 2. ALMO KONSTRUKSION shpk

J91915001P

*Emri i plotë i shoqërisë**Numri i NIPT-t*

Operatori Ekonomik ALMO KONSTRUKSION sh.p.k skualifikohet nga ky tender për arsyet e poshteshuara:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022, dhe 2023 lëshuar nga administrata tatimore, ku vlera e xhiros në të paktën 1 (një) nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më e vogël se 100 % e fondit limit të kontratës që prokurohet.

*Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.*

- ❖ Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit ekonomik ALMO KONSTRUKSION shpk pasi xhiro vjetore për vitet financiare 2021,2022 dhe 2023 duhet të jetë jo më e vogël se 100 % e fondit limit të kontratës që prokurohet kurse xhiroja e operatorit ekonomik për periudhën e kërkuar është me e vogël se 100 % e fondit limit.

2.3.5 Për Listën e mallrave/ materialeve të përcaktuara në Preventivin objekt prokurimi, listën si më poshtë:

- Tuba HDPE/ PN 10 sipas dimensioneve të kërkuara në Projekt – preventivin dhe Specifikimeve teknike
- Tuba të brinjëzuar HDPE SN 8 sipas dimensioneve të kërkuara në Projekt - preventivin dhe Specifikimeve teknike

Operatori ekonomik duhet të paraqesë:

1. Autorizim të prodhuesit/ve ose nga distributor i autorizuar prej prodhuesit ose Marrëveshje bashkëpunimi (ose ekuivalenti i tij/saj) të zyrtarizuar, e cila të tregojë lidhjen midis ofertuesit dhe prodhuesit ose midis ofertues-distributor-prodhues për listën e mësipërme të mallrave lëshuar/ lidhur jo më parë se data e publikimit të procedurës së prokurimit. Autorizimi/ Marrëveshja bashkëpunimit duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.
2. Katalogun/ët ose fragmente të katalogut/ëve e prodhuesit/ve për listën e mësipërme, në të cilët të tregohen dhe të specifikohen qartë materialet që do të ofrohen.

*Shënim: Fragmentet e katalogut/ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qartë që janë pjesë katalogu, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i përkasin.*

3. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë dëshmi të testimeve zyrtare të kryera, të lëshuara nga institucione të autorizuar ose nga prodhuesi, që vërtetojnë pajtueshmërinë e materialeve të prodhuara (lista e mësipërme) me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara
- ❖ Ky kush nuk përmbushet nga operatori ekonomik pasi mungojnë:
    - I. Mungon Autorizim të prodhuesit/ve ose nga distributor i autorizuar prej prodhuesit ose Marrëveshje bashkëpunimi (ose ekuivalenti i tij/saj) të zyrtarizuar, e cila të tregojë lidhjen midis ofertuesit dhe prodhuesit ose midis ofertues-distributor-prodhues.
    - II. Mungon katalogu ose fragmente të katalogut/ëve e prodhuesit/ve.
    - III. Mungojnë dëshmitë e testimeve zyrtare të kryera, të lëshuara nga institucione të autorizuar ose nga prodhuesi, që vërtetojnë pajtueshmërinë e materialeve të prodhuara (lista e mësipërme) me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara

#### 2.3.8 (Makineri, Pajisje)

- b) Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, automjetet dhe pajisjet (sipas tabelës) të cilat duhet të jenë në pronësi të tij ose me qira të vërtetuara këto me dokumentacionin përkatës;

- ❖ Ky kush nuk përmbushet nga operatori ekonomik pasi nuk ploteson makinerite e kerkuara Ne shtojcen 8 nuk ka deklaruar se ka ne pronesi ose me qera makinerite e meposhtme:

1. Kamion vetshkarkues 10-20 ton ka deklaruar 2(dy) copë ne vend te 3(tre)
2. Kamion 5-10 ton 0 (zero) nga 4(katër) te kerkuar
3. Dumper 0(zero) nga 2(dy) te kerkuar
4. Makineri per skarifikim te shtresave asfaltike 0(zero) nga 1(nje) te kerkuar
5. Depozite uji 2000 l 0(zero) nga 1(nje) te kerkuara
6. Saldatrice 0(zero) nga 2(dy) te kerkuara
7. Aparature elektro fuzion 0(zero) nga 1(nje) te kerkuara.

#### 2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon:

- a. punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet (pa TVSH) dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

#### Ose

- b. punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku e realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet (pa TVSH).

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e ben oferten të kualifikueshme.

- ❖ Kriteri 2.3.1 i kapacitetit teknik i kriterëve të veçanta për kualifikim nuk përmbushet nga operatori ekonomik ALMO KONSTRUKSION shpk pasi kontrata e paraqitur si kontrata e ngjashme është me vlerë të vogël se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet (pa TVSH) dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës për një objekt të vetëm. (mungon elementi vlerë).
- ❖ *Në bazë të përcaktimeve të legjislacionit për prokurimin publik, të parashikuara edhe në dokumentat e tenderit, bazuar edhe në konceptin e përgjithshëm të prokurimeve, objektet/ kontratat e ngjashme që të mund të konsiderohen të tilla duhet të plotësojnë në mënyrë kumulative elementin e kohës, vlerës dhe natyrës së ngjashme. Pra, (i) objekti i përfunduar i kontratës duhet të jenë brenda afatit (elementi kohë), (ii) duhet të plotësojnë madhësinë e kërkuar nga autoriteti kontraktor, 50% apo 200% (elementi vlerë) dhe (iii) duhet të jenë të ngjashme me objektin që prokurohet (elementi natyrë e ngjashme). Mungesa qoftë edhe një prej këtyre elementëve e bën të pavlefshëm eksperiencën e ngjashme të paraqitur nga kandidati ofertues.*

## 2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

- ❖ Ky kusht nuk përmbushet nga operatori ekonomik pasi nuk ka paraqitur sigurimin e ofertes.

2.3.2 Operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë se disponojnë licensë profesionale për zbatim punimesh në ndërtim si dhe në licensë të disponojnë kategoritë e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesin licensën përkatëse të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr.42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar. Licenca profesionale e operatorit ekonomik lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës duhet të përmbajë kategoritë e mëposhtme:

- Për punimet e përgjithshme të ndërtimit, operatori ekonomik duhet të disponojë kategoritë e mëposhtme në licensë:
  - Kategoria NP-1 (Punime gërmimi në tokë) – Klasifikimi C
  - Kategoria NP-4 (Rruge, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale) – Klasifikimi C
  - Kategoria NP-7 (Ujësjiellës, gazsjiellës, vajsjiellës, vepra kullimi e vaditje) – Klasifikimi E
  - Kategoria NP-12 (Punime të inxhinierisë së mjedisit) – Klasifikimi A
- Për punimet speciale të ndërtimit, operatori ekonomik duhet të disponojë kategoritë e mëposhtme në licensë:
  - Kategoria NS-1 (Punime për prishjen e ndërtimeve) – Klasifikimi A



- Kategoria NS-8 (Ndërtimë parafabrikat beton arme, struktura...) – Klasifikimi A
- Kategoria NS-18 (Punime topogjeodezike ) – Klasifikimi A

\* Për Operatorët e huaj të bëhet njehësimi i licensës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Ministrisë së Punëve Publike Transportit dhe Telekomunikacionit në plotësimin e licensave profesionale të kërkua për ekzekutimin e kontratës.

\* Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomikë, Licensat profesionale duhet t'i paraqesë operatori ekonomik që ka marrë përsipër punimet për të cilat kërkohet Licensa Profesionale.

- ❖ Ky kush nuk përmbushet nga operatori ekonomik pasi Kategoria NP-7 nuk është e klasifikimit E por është e klasifikimit D.

### 3. KRONOS KONSTRUKSION shpk Emri i plotë i shoqërisë

K41416033P  
Numri i NIPT-t

\_Operatori Ekonomik Kronos Konstruksion sh.p.k skualifikohet nga ky tender per arsyet e poshteshenuara:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon:

- c. punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet (pa TVSH) dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Ose

- d. punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku e realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet (pa TVSH).

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e ben oferten të kualifikueshme.

- ❖ Kriteri 2.3.1 i kapacitetit teknik i kriterëve të vecanta për kualifikim nuk përmbushet nga operatori ekonomik Kronos Konstruksion shpk pasi kontrata e paraqitur si kontrata e ngjashme është me e vogël se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet (pa TVSH) dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës për një objekt të vetëm. (mungon elementi vlerë).
- ❖ Në bazë të përcaktimeve të legjislacionit për prokurimin publik, të parashikuara edhe në dokumentat e tenderit, bazuar edhe në konceptin e përgjithshëm të prokurimeve, objektet/ kontratat e ngjashme që të mund të konsiderohen të tilla duhet të plotësojnë në mënyrë kumulative elementin e kohës, vlerës dhe natyrës së ngjashme. Pra, (i) objekti i përfunduar i kontratës duhet të jenë brenda afatit (elementi kohë), (ii) duhet të plotësojnë madhësinë e kërkuar nga autoriteti kontraktor, 50% apo 200% (elementi vlerë) dhe (iii) duhet të jenë të ngjashme me objektin që prokurohet (elementi natyrë e ngjashme). Mungesa qoftë edhe një prej këtyre elementëve

e bën të pavlefshëm eksperiencën e ngjashme të paraqitur nga kandidati ofertues.

2.3.5 Për Listën e mallrave/ materialeve të përcaktuara në Preventivin objekt prokurimi, listën si më poshtë:

- Tuba HDPE/ PN 10 sipas dimensioneve të kërkuara në Projekt – preventivin dhe Specifikimeve teknike
- Tuba të brinjëzuar HDPE SN 8 sipas dimensioneve të kërkuara në Projekt - preventivin dhe Specifikimeve teknike

Operatori ekonomik duhet të paraqesë:

1. Autorizim të prodhuesit/ve ose nga distributor i autorizuar prej prodhuesit ose Marrëveshje bashkëpunimi (ose ekuivalenti i tij/saj) të zyrtarizuar, e cila të tregojë lidhjen midis ofertuesit dhe prodhuesit ose midis ofertues-distributor-prodhues për listën e mësipërme të mallrave lëshuar/ lidhur jo më parë se data e publikimit të procedurës së prokurimit. Autorizimi/ Marrëveshja bashkëpunimit duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.
2. Katalogun/ët ose fragmente të katalogut/ëve e prodhuesit/ve për listën e mësipërme, në të cilët të tregohen dhe të specifikohen qartë materialet që do të ofrohen.

Shënim: Fragmentet e katalogut/ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qartë që janë pjesë katalogu, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i përkasin.

3. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë dëshmi të testimeve zyrtare të kryera, të lëshuara nga institucione të autorizuar ose nga prodhuesi, që vërtetojnë pajtueshmërinë e materialeve të prodhuara (lista e mësipërme) me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara

❖ Ky kush nuk përmbushet nga operatori ekonomik Kronos Konstruktion shpk pasi mungojnë:

- I. Mungon Autorizim të prodhuesit/ve ose nga distributor i autorizuar prej prodhuesit ose Marrëveshje bashkëpunimi (ose ekuivalenti i tij/saj) të zyrtarizuar, e cila të tregojë lidhjen midis ofertuesit dhe prodhuesit ose midis ofertues-distributor-prodhues.
- II. Mungon katalogu ose fragmente të katalogut/ëve e prodhuesit/ve.
- III. Mungojnë dëshmitë e testimeve zyrtare të kryera, të lëshuara nga institucione të autorizuar ose nga prodhuesi, që vërtetojnë pajtueshmërinë e materialeve të prodhuara (lista e mësipërme) me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara

2.3.8 (Makineri, Pajisje)

- c) Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, automjetet dhe pajisjet (sipas tabelës) të cilat duhet të jenë në pronësi të tij ose me qira të vërtetuara këto me dokumentacionin përkatës;

- ❖ Ky kush nuk përmbushet nga operatori ekonomik pasi nuk ploteson makinerite e kerkuara Ne shtojcen 8 nuk ka deklaruar se ka ne pronesi ose me qera makinerite e meposhtme:

1. Nr. 2.	Përshkrimi i Automjetit/ mjetit/ Pajisjes	Sasia
2.	Kamiona vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 10 -20 ton	jo më pak se 3 copë
3.	Kamiona vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 5 -10 ton	jo më pak se 3 copë
4.	Kamion/ Kamionçinë me kapacitet mbajtës deri 3.5 ton	jo më pak se 3 copë
6.	Dumper	jo më pak se 1 copë
7.	Grejder	jo më pak se 1 copë
10.	Eskavator me zinxhir	jo më pak se 2 copë
11.	Minieskavator	jo më pak se 1 copë
13.	Autobitumatrice	jo më pak se 1 copë
14.	Autobot uji	jo më pak se 1 copë
16.	Rimorkiator për transportin e makinerive	jo më pak se 1 copë
17.	Çekic pneumatik	jo më pak se 1 copë
18.	Betoniere 0.33 m <sup>3</sup>	jo më pak se 4 copë
19.	Kallëperi	jo më pak se 200 m <sup>2</sup>
20.	Pompë uji	jo më pak se 2 copë
21.	Vibrator	jo më pak se 2 copë
22.	Matës largësie / Instrument për Topogjeodezim	jo më pak se 1 copë
23.	Matrapik	jo më pak se 2 copë
26.	Aparature per bashkim tubacionesh me metoden “ Elektro Fusion ”	jo më pak se 2 copë
27.	Makineri e skarifikimit te shtresave asfaltike	jo më pak se 1 copë
28.	Aparature per bashkim tubacionesh me metoden “koke me koke ”	jo më pak se 2 copë
29.	Depozita uji minimumi 2000 litra	jo më pak se 1 copë
30.	Saldatriçe	jo më pak se 2 copë

#### 4. LIS KONSTRUKSION shpk & VIANTE Konstruksion shpk K66613407H & K47103804L

*Emri i plotë i shoqërisë*

*Numri i NIPT-t*

Bashkimi i Operatoreve Ekonomik LIS KONSTRUKSION sh.p.k & VIANTE KONSTRUKSION sh.p.k skualifikohet nga ky tender per arsyet e poshteshenuara:

2.3.5 Për Listën e mallrave/ materialeve të përcaktuara në Preventivin objekt prokurimi, listën si më poshtë:

- Tuba HDPE/ PN 10 sipas dimensioneve të kërkuara në Projekt – preventivin dhe Specifikimeve teknike
- Tuba të brinjëzuar HDPE SN 8 sipas dimensioneve të kërkuara në Projekt - preventivin dhe Specifikimeve teknike

Operatori ekonomik duhet të paraqesë:

1. Autorizim të prodhuesit/ve ose nga distributor i autorizuar prej prodhuesit ose Marrëveshje bashkëpunimi (ose ekuivalenti i tij/saj) të zyrtarizuar, e cila të tregojë lidhjen midis ofertuesit dhe prodhuesit ose midis ofertues-distributor-prodhues për listën e mësipërme të mallrave lëshuar/lidhur jo më parë se data e publikimit të procedurës së prokurimit. Autorizimi/ Marrëveshja bashkëpunimit duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.
2. Katalogun/ët ose fragmente të katalogut/ëve e prodhuesit/ve për listën e mësipërme, në të cilët të tregohen dhe të specifikohen qartë materialet që do të ofrohen.

*Shënim: Fragmentet e katalogut/ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qartë që janë pjesë katalogu, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i përkasin.*

3. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë dëshmi të testimeve zyrtare të kryera, të lëshuara nga institucione të autorizuar ose nga prodhuesi, që vërtetojnë pajtueshmërinë e materialeve të prodhuara (lista e mësipërme) me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara

❖ Ky kush nuk përmbushet nga operatori ekonomik BOE LIS KONSTRUKSION shpk & VIANTE KONSTRUKSION shpk pasi mungojnë:

- I. Operatori ekonomik VIANTE KONSTRUKSION shpk nuk ka paraqitur autorizim të prodhuesit/ve ose nga distributor i autorizuar prej prodhuesit ose Marrëveshje bashkëpunimi (ose ekuivalenti i tij/saj) të zyrtarizuar, e cila të tregojë lidhjen midis ofertuesit dhe prodhuesit ose midis ofertues-distributor-prodhues për tubat:  
40 An40 FV Tuba e rakorderi ujesjellesi PE d=140mm Pn 10 ml 1615  
An41 FV Tuba e rakorderi ujesjellesi PE d=225mm Pn 10 ml 3610  
Te cilat do të realizohen nga ky operator sipas marreveshjes së bashkëpunimit.
- II. Mungon katalogu ose fragmente të katalogut/ëve e prodhuesit/vet të tubave të mësipërm.
- III. Mungojnë dëshmitë e testimeve zyrtare të kryera, të lëshuara nga institucione të autorizuar ose nga prodhuesi, që vërtetojnë pajtueshmërinë e materialeve të prodhuara (tubat e mësipërme) me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara.
- IV. Operatori ekonomik LIS KONSTRUKSION nuk ka paraqitur katalog ose fragmente të katalogut/ëve e prodhuesit/vet të tubave

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon:

- a. punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet (pa TVSH) dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Ose

- b. punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku e realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet (pa TVSH).

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e ben oferten të kualifikueshme.

Nuk përmbush kriteret për kapacitetin teknik, për përvojën në realizimin e punëve të ngjashme, për objektin “Rrjeti shperndares I furnizimit me uje dhe te KUZ te zones se Fruti Kultures, Valias I Vjetër, Bashkia Kamëz”. Pasi referuar kriterëve të vendosura në DST, për të konsideruar një ofertë të kualifikueshme, duhen përmbushur një nga dy kushtet e mëposhtme: a) Punë të Ngjashme për Një Objekt të Vetëm: Vlera e kontratës së realizuar duhet të jetë jo më e vogël se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet). b) Punë të Ngjashme me Shumë Kontrata: Vlera monetare totale e punëve të kryera nga operatori ekonomik gjatë pesë viteve të fundit duhet të jetë jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet. Konkretisht Mosplotësimi i Kushteve të Sipërpërmendura per operatorin ekonomik “Lis Konstruksion” shpk pasi kontratat e paraqitura nga ky opertor nuk arrijnë vlerën e kërkuar. Referuar Përcaktimeve te Legjislacionit për Prokurimin Publik dhe dokumenteve të tenderit, si dhe konceptit të përgjithshëm të prokurimeve, objektet/kontratat e ngjashme, operatorët ekonomik duhet te përmbushin këto elemente:

- Elementi Kohë: Kontratat duhet të jenë përfunduar brenda pesë viteve të fundit nga data e publikimit të njoftimit të kontratës.

- Elementi Vlerë: Madhësia e kontratave duhet të përmbushë kërkesën e autoritetit kontraktor, qoftë 50% apo 200% të vlerës së kontratës që prokurohet.

- Elementi Natyrë e Ngjashme: Kontratat duhet të jenë të ngjashme me objektin që prokurohet. Përmbushja e këtyre kriterëve është e domosdoshme për të konsideruar përvojën e një operatori ekonomik si të vlefshme.

Mungesa e përmbushjes së një prej këtyre elementëve (kohë, vlerë, natyrë e ngjashme) e bën të pavlefshme përvojën e paraqitur nga kandidatët ofertues. Sa me sipër, Operatori Ekonomik: “Lis Konstruksion” shpk, skualifikohet nga ky tender. Ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto DT do të refuzohen si të papranueshme.”

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së mësipërme, informojmë *Shoqërinë* “ITE GROUP” SH.PK. me NIPT K11323001H, *Adresa:* Tirane Tirane TIRANE Rruga Dytesore Autostrada Tirane- Dures, Km 5, se vlera e pritshme e *marrëveshjes kuadër* dhe oferta e paraqitur me vlere 3,947,052 (tremilion e nëntëqind e dyzet e shtatë mijë e pesëdhjetë e dy) lekë pa TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BURGJEVE**

Drejtuar: “SWISSMED” SHPK , me NIPT K81323024G, Adresa: Tiranë, Njesia Bashkiake nr.11, Rruga Dritan Hoxha, Ndertesa 92, seksioni 4, Hyrja 28, Kodi Postar, 1026, zona kadastrale Nr.8310.

Procedura e prokurimit/lotit: E Hapur e Thjeshtuar – Mallra

Numri i procedurës / referenca e Lotit: REF-12250-07-05-2024

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “Blerje Pajisje Mjekësore për Shëndetësinë”

Artikulli	Përshkrimi	Njesia	Shuma
1.	Aparat elektrokardiograme	cope	2
2.	Aparat kliniko-biokimik, Analizator Hematologjik Automatik Analizatori kimik gjysëautomatik i urinës	cope	1
3.	Oksimetër	cope	40
4.	Llampë polimerizimi	cope	8
5.	Defibrilator AED	cope	5
6.	Frigorifer për medikamente	cope	8
7.	Krevat për kufizim fizik	cope	10
8.	Këmisha force	cope	10
9.	Roller mixer për gjakun	cope	2
10.	Centrifuge	cope	2

Afati i ekzekutimit: 40 ditë nga nënshkrimi i kontratës.

Publikimet e mëparshme (*nëse është rasti*): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. “SWISSMED” SHPK

K81323024G



Vlera: 6'056'000 (gjashtë milion e pesëdhjetë e gjashtë mijë) Lekë pa TVSH.

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:  
Nuk ka.

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë “SWISSMED” SHPK me adresë: Tiranë, Njesia Bashkiake nr.11, Rruga Dritan Hoxha, Ndertesa 92, seksioni 4, Hyrja 28, Kodi Postar, 1026, zona kadastrale Nr.8310, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 6'056'000 (gjashtë milion e pesëdhjetë e gjashtë mijë) Lekë pa TVSH është identifikuar si fitues (paraparak) i procedurës së prokurimit.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.

## **MINISTRIA E SHËNDETËSISE DHE MBROJTJES SOCIALE**

Drejtuar: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të suksesshëm]

1. ALFARMAKOS SHPK me NIPT K52115005W dhe me adresë Tirane Fshati Katund i Ri, Autostrada Tirane Durres, km.6, ndertesa nr.211/1, zk.2119

\* \* \*

Procedura e prokurimit: e hapur mbi kufirin e lartë monetar - prokurim me mjete elektronike - mallra.

Numri i procedurës / referenca e Lotit: REF-05453-05-20-2024

	Lot/Principi aktiv	Referenca
	Lot12 Ciprofloxacine	REF-05483-05-20-2024

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “B2 - Blerje barna Anti-infektivë të përgjithshëm, Gjaku dhe organet formuese të gjakut, Sistemi muskolo-skeletik, Sistemi nervor dhe Sistemi respirator”, ndarë në 129 lote - Marrëveshje Kuadër me disa operatorë ekonomik (një OE të vetëm të suksesshëm për sejcilin lot)- ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 24 muaj” me fond limit/vlera e pritshme e kontratave në total prej 6,216,677,709 (gjashtë miliard e dyqind e gjashtëmbëdhjetë milion e gjashtëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e shtatëqind e nëntë) Lekë pa TVSH.

Fondi limit/vlera e pritshme e kontratave i konvertuar në euro sipas kursit zyrtar të Bankës së Shqipërisë datë 20/05/2024: 61,912,934 Euro pa TVSH.

Ndarë në lote:

B2 - Blerje barna Anti-infektivë të përgjithshëm, Gjaku dhe organet formuese të gjakut, Sistemi muskolo-skeletalik, Sistemi nervor dhe Sistemi respirator”, ndarë në 129						
Sistemi	Lot/Principi aktiv	Formedoza	Njesia	Sasia totale e parashikuar 24 muaj	Vlera limit e parashikuar 24 muaj në lekë pa TVSH	Vlera limit e parashikuar 24 muaj në Euro
Anti-infektive te pergjithshem	Lot12 Ciprofloxacine	200 mg/100 ml - 100 ml	Flakon	92,080	57,313,022	570,790

Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj: Kontratat mund të lidhen nga AK përfituese brenda afatit 24 muaj nga data e nënshkrimit të MK nga palët, për sejcilin lot.

Publikimet e mëparshme (*nëse është rasti*): Nuk ka.

Buletini i Njoftimeve Publike: *Datë 27.05.2024, Nr. 27.*

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të kësaj bëjmë me dije se, në këtë procedurë/Lot kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë të mëposhtëm me vlerat përkatëse si më poshtë:

➤ Lot12 Ciprofloxacine 200 mg/100 ml - 100 ml Flakon REF-05483-05-20-2024

1. ALDOSCH - FARMA shpk me NIPT K31503045V dhe adresë Tirane Rruga Myslym Keta, Ish - Antibiotiku ofertuar në vlerën 8,747,600.00 lekë pa tvsh
2. ALFARMAKOS SHPK me NIPT K52115005W dhe me adresë Tirane Fshati Katund i Ri, Autostrada Tirane Dures, km.6, ndertesa nr.211/1, zk.2119 ofertuar në vlerën 13,627,840.00 lekë pa tvsh
3. FLORFARMA shpk me NIPT K21405001N dhe adresë Tirane Rruga Qazim Vathi, Nr.72. ofertuar në vlerën 17,495,200.00 lekë pa tvsh
4. REJSI FARMA shpk me NIPT J91419001U dhe adresë Tirane Vore Autostrada Tirane-Dures, km 8, (prane nenkalimit te autostrades), nr.1 ofertuar në vlerën 17,771,440.00 lekë pa tvsh
5. ILMA shpk me NIPT K21912001R dhe adresë Tirane Njesia Bashkiake Nr 3, Rruga Xhanfize Keko , Pallati AIA , Kati -1, Prane Ish Profarma ofertuar në vlerën 18,139,760.00 lekë pa tvsh
6. winpharma SHPK me NIPT L21508008T dhe adresë Tirane Selite e Vjeter, Nd 4,kati i I dhe i II, Njesia administrative nr 13, Selite 1044. ofertuar në vlerën 18,406,792.00 lekë pa tvsh
7. PARTNERS PHARMA shpk me NIPT L91612011A dhe adresë Tirane Prona ZK. 3292, vol 8, faqe 203, numri i pasurise 109/24, (truall 414 m2+ndertese 386 m2), Prona

ZK. 3292, vol 59, faqe 234, numri i pasurise 109/24, (ndertese 119 m2), Rr.Rrapo Hekali, Ndertese Private, afer Njesis administrative Nr.13 ofertuar në vlerën 19,336,800.00 lekë pa tvsh

8. EDNA - FARMA shpk me NIPT K01515004T dhe adresë Tirane Ish Kombinati Josif Pashko, Laprake ofertuar në vlerën 21,086,320.00 lekë pa tvsh

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

➤ Lot12 Ciprofloxacine 200 mg/100 ml - 100 ml Flakon REF-05483-05-20-2024

1. ALDOSCH - FARMA shpk me NIPT K31503045V dhe adresë Tirane Rruga Myslym Keta, Ish - Antibiotiku ofertuar në vlerën 8,747,600.00 lekë pa tvsh

Përkatesisht për arsyet e mëposhtme:

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur në SPE oferta e OE rezultoi anomalisht e ulët. KVO më datë 09.07.2024 dërgon nëpërmjet SPE kërkesën për sqarim oferte anomalisht të ulët. Më datë 11.07.2024 OE paraqet argumentimin ku për lot 12 deklaron se cmimi I ofertuar është lapsus nga ana e tyre e për rrjedhojë ky bar nuk mund të furnizohet me cmimin e ofertuar.

Për sa mësipër OE ALDOSCH – FARMA skualifikohet.

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, ju informojmë se operatorët ekonomikë të mëposhtëm janë identifikuar si të suksesshëm:

➤ Lot12 Ciprofloxacine 200 mg/100 ml - 100 ml Flakon REF-05483-05-20-2024

1. ALFARMAKOS SHPK me NIPT K52115005W dhe me adresë Tirane Fshati Katund i Ri, Autostrada Tirane Durres, km.6, ndertesa nr.211/1, zk.2119 ofertuar në vlerën 13,627,840.00 (trembëdhjetë milion e gjashtëqind e njëzet e shtatë mijë e tetëqind e dyzet) lekë pa tvsh / totali i pikëve të marra [\_\_\_\_\_] është identifikuar si Oferta e suksesshme.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.

**MINISTRIA E SHËNDETËSISE DHE MBROJTJES SOCIALE**

Drejtuar: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të suksesshëm]

1. PHARMA ONE sh.p.k. shpk me NIPT K72228008B dhe adresë Tirane Kashar Kilometri 6, Autostrada Tirane - Durres, Prane Fabrikes Prodhimit te Mobiljeve
2. DELTA PHARMA - AL shpk me NIPT K62202046U dhe adresë Tirane Kashar MEZEZ Autostrada Tirane - Durres, km.3, zona kadastrale 2679, nr.pasurie 19/27/1

\* \* \*

Procedura e prokurimit: e hapur mbi kufirin e lartë monetar - prokurim me mjete elektronike - mallra.

Numri i procedurës / referenca e Lotit: REF-03249-05-02-2024

	Lot56 Iodine x 370mg/ml	REF-03378-05-02-2024
	Lot70 Omeprazole	REF-03409-05-02-2024

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “B1 - Blerje barna sistemet Anestezi reanimacion, Anti tuberkulare, Antineoplastike dhe imunomodulatore, Barna antiparazitare, Barna dermatologjike, Barna hormonale sistemike, Lëndë kontrasti për CT, Lëndë kontrasti për MRI, Lëndë kontrasti gastrointestinale, Metabolizmi dhe trakti tretës, Organet e shqisave, Psikiatria, Sistemi kardiovaskular”, ndarë në 115 lote - Marrëveshje Kuadër me disa operatorë ekonomik (një OE të vetëm të suksesshëm për sejcilin lot)- ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 24 muaj” me fond limit/vlera e pritshme e kontratave në total prej 3,660,634,272 (tre miliard e gjashtëqind e gjashtëdhjetë milion e gjashtëqind e tridhjetë e katër mijë e dyqind e shtatëdhjetë e dy) Lekë pa TVSH.

Fondi limit/vlera e pritshme e kontratave i konvertuar në euro sipas kursit zyrtar të Bankës së Shqipërisë datë 02/05/2024: 36,493,214 Euro pa TVSH.

Ndarë në lote:

“B1 - Blerje barna sistemet Anestezi reanimacion, Anti tuberkulare, Antineoplastike dhe imunomodulatore, Barna antiparazitare, Barna dermatologjike, Barna hormonale sistemike, Lëndë kontrasti për CT, Lëndë kontrasti për MRI, Lëndë kontrasti gastrointestinale, Metabolizmi dhe trakti tretës, Organet e shqisave, Psikiatria, Sistemi kardiovaskular”, ndarë në 115 lote						
Sistemi	Lot/Principi aktiv	Formedoza	Njesia	Sasia totale e parashikuar 24 muaj	Vlera limit e parashikuar 24 muaj në lekë pa TVSH	Vlera limit e parashikuar 24 muaj në Euro
Lende kontrasti per CT	Lot56 Iodine x 370mg/ml	100 ml	Flakon	29,950	91,932,902	916,488

Metabolizmi dhe trakti tretes	Lot70 Omeprazole	20 mg	Kapsule	608,407	12,564,500	125,257
-------------------------------	------------------	-------	---------	---------	------------	---------

Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj: Kontratat mund të lidhen nga AK përfituese brenda afatit 24 muaj nga data e nënshkrimit të MK nga palët, për sejcilin lot.

Publikimet e mëparshme (*nëse është rasti*): Nuk ka.

Buletini i Njoftimeve Publike: *Datë 07.05.2024, Nr. 23.*

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të kësaj bëjmë me dije se, në këtë procedurë/Lot kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë të mëposhtëm me vlerat përkatëse si më poshtë:

➤ Lot56 Iodine x 370mg/ml 100 ml Flakon REF-03378-05-02-2024

1. INCOMED shpk me NIPT K91530017T dhe adresë Tirane Vaqarr LALM Zona Kadstrale 2376, Nr. pasurie 103/17-ND dhe 103/17 ofertuar në vlerën 45,823,500.00 lekë pa tvsh.
2. DELTA PHARMA - AL shpk me NIPT K62202046U dhe adresë Tirane Kashar MEZEZ Autostrada Tirane - Durres, km.3, zona kadastrale 2679, nr.pasurie 19/27/1 ofertuar në vlerën 59,115,310.00 lekë pa tvsh.

➤ Lot70 Omeprazole 20 mg Kapsule REF-03409-05-02-2024

1. ALDOSCH - FARMA shpk me NIPT K31503045V dhe adresë Tirane Rruga Myslym Keta, Ish -Antibiotiku ofertuar në vlerën 3,042,035.00 lekë pa tvsh.
2. DELTA PHARMA - AL shpk me NIPT K62202046U dhe adresë Tirane Kashar MEZEZ Autostrada Tirane - Durres, km.3, zona kadastrale 2679, nr.pasurie 19/27/1 ofertuar në vlerën 3,820,795.96 lekë pa tvsh.
3. PHARMA ONE sh.p.k. shpk me NIPT K72228008B dhe adresë Tirane Kashar Kilometri 6, Autostrada Tirane - Durres, Prane Fabrikes Prodhimit te Mobiljeve ofertuar në vlerën 4,988,937.40 lekë pa tvsh.
4. INCOMED shpk me NIPT K91530017T dhe adresë Tirane Vaqarr LALM Zona Kadstrale 2376, Nr. pasurie 103/17-ND dhe 103/17 ofertuar në vlerën 7,300,884.00 lekë pa tvsh.
5. T R I M E D shpk me NIPT K51612031J dhe adresë Tirane Kashar Autostrada ""Tirane - Durres"", Km 10, Zone Kadastrale 2105, Nr.Pasurie 95/11. ofertuar në vlerën 12,168,140.00 lekë pa tvsh.

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

➤ Lot56 Iodine x 370mg/ml 100 ml Flakon REF-03378-05-02-2024

1. INCOMED shpk me NIPT K91530017T dhe adresë Tirane Vaqarr LALM Zona Kadstrale 2376, Nr. pasurie 103/17-ND dhe 103/17 ofertuar në vlerën 45,823,500.00 lekë pa tvsh.

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Pas shqyrtimit të dokuemnatacionit të paraqitur në SPE oferta e OE INCOMED shpk rezulton anomalisht e ulët. Më datë 24.06.2024 nëpërmjet SPE KVO i dërgon kërkesën për saqrim. OE për Lot56 kërkon edhe 2 ditë pune kohë shtesë për të marrë konfirmim cmimi nga prodhuesi. KVO pregatiti njoftimin e fituesit perfundimtar ku u përfshi edhe ky lot por ndërkohë përgjigja e ofertës anomalisht të ulët nuk erdhi. KVO e vuri re këtë lapsus dhe kërkoi rikthimin e këtij loti por me emailin e datës 15.07.2024 njofton se për ta rikthyer këtë lot për rivlerësim duhet të përfundonin afatet e ankimimit. Në përfundim të afateve KVO bën rivlerësimin në sistem dhe skualifikon OE INCOMED. Nga sa më sipër oferta e këtij operatori skualifikohet.

➤ Lot70 Omeprazole 20 mg Kapsule REF-03409-05-02-2024

1. ALDOSCH - FARMA shpk me NIPT K31503045V dhe adresë Tirane Rruga Myslym Keta, Ish -Antibiotiku ofertuar në vlerën 3,042,035.00 lekë pa tvsh.

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të ngarkuar në SPE, rezulton se oferta e OE është anomalisht e ulët. Më datë 24.06.2024 KVO nëpërmjet SPE i dërgon OE kërkesën për sqarim dhe më datë 27.06.2024 OE sjell përgjigjen ku citon se për Lot70 dhe Lot101 është bërë lapsus nga ana e tyre në vendosjen e cmimit.

Nga sa më sipër oferta e këtij operatori skualifikohet.

2. DELTA PHARMA - AL shpk me NIPT K62202046U dhe adresë Tirane Kashar MEZEZ Autostrada Tirane - Durres, km.3, zona kadastrale 2679, nr.pasurie 19/27/1 ofertuar në vlerën 3,820,795.96 lekë pa tvsh.

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Pas skualifikimit të OE, ALDOSCH – FARMA KVO kalon te operatori i renditur tjetër DELTA PHARMA – AL. Edhe oferta e këtij operatori rezulton anomalisht e ulët dhe më datë 02.07.2024 KVO nëpërmjet SPE i dërgon kërkesën për ofertë anomalisht të ulët. Më datë 05.07.2024 OE dërgon përgjigje 68 datë 05.07.2024, në të cilën nuk jep asnjë argumentim apo mbështetje cmimi sikurse është cituar në kërkesë dhe deklaron që informacioni i ndarë është kofidencial.

Nga sa më sipër oferta e këtij operatori skualifikohet.

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, ju informojmë se operatorët ekonomikë të mëposhtëm janë identifikuar si të suksesshëm:

➤ Lot56 Iodine x 370mg/ml 100 ml Flakon REF-03378-05-02-2024

1. DELTA PHARMA - AL shpk me NIPT K62202046U dhe adresë Tirane Kashar MEZEZ Autostrada Tirane - Durres, km.3, zona kadastrale 2679, nr.pasurie 19/27/1 ofertuar në vlerën 59,115,310.00 (pesëdhjetë e nëntë milion e njëqind e pesëmbëdhjetë mijë e treqind e dhjetë) lekë pa tvsh / totali i pikëve të marra [\_\_\_\_\_] është identifikuar si Oferta e suksesshme.

➤ Lot70 Omeprazole 20 mg Kapsule REF-03409-05-02-2024

2. PHARMA ONE sh.p.k. shpk me NIPT K72228008B dhe adresë Tirane Kashar Kilometri 6, Autostrada Tirane - Durres, Prane Fabrikes Prodhimit te Mobiljeve ofertuar në vlerën 4,988,937.40 (katër milion e nëntëqind e tetëdhjetë e tetë mijë e nëntë qind e tridhjetë e

shtatë).4 lekë pa tvsh / totali i pikëve të marra [\_\_\_\_\_] është identifikuar si Oferta e suksesshme.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.

### **DREJTORIA E PËRGJITHSHME E KOPSHTIT ZOOLOGJIK**

Drejtuar: “TRINITY TRADE COMPANY” sh.p.k. me NUIS: K81630026U

Adresa: Tirane Tirane TIRANE Njesia Administrative Nr.10, Rruga Alqi Boshnjaku (ish Rruga Reshit Çollaku), Ndertesa Nr.38, Hyrja 6, Ap.1, Kodi Postar 1001.

Procedura e prokurimit/lotit: “*Procedurë e hapur e thjeshtuar, mallra*”

Numri i procedurës / referenca e Lotit: REF-12631-07-09-2024

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “*Blerje pajisje për veterinari*”, me fond limit 3,586,333 (tre milion e pesëqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e treqind e tridhjetë e tre) lekë pa TVSH.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomkisht më e favorshme bazuar në kosto

oferta ekonomkisht më e favorshme bazuar në çmim X

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik “TRINITY TRADE COMPANY” sh.p.k. me NUIS: K81630026U

Vlera e ofertës pa tvsh = 3,458,800 (tre milion e katërqind e pesëdhjetë e tetë mijë e tetëqind) lekë.

2. Operatori ekonomik “ALMedical” sh.p.k. me NUIS: K21511002I

Nuk ka paraqitur ofertë (Nuk është paraqitur Shtojca 1 dhe Shtojca 2).

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

Operatori ekonomik “ALMedical” sh.p.k. me NUIS: K21511002I

Për arsyet e mëposhtme:

- Nuk ka paraqitur Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;
- Nuk ka paraqitur Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

- Nuk ka paraqitur xhiron vjetore të realizuar për vitet financiare (2021, 2022, 2023) ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar është në një vlerë jo më e vogël se 40% të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.;
- Nuk ka paraqitur dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate;
- Nuk ka paraqitur autorizimin nga prodhuesi për pajisjet veterinare;
- Nuk ka paraqitur katalogët nga prodhuesi për pajisjet veterinare;
- Nuk ka paraqitur deklaratën lidhur me montimin dhe instalimin pranë ambienteve të caktuara nga Autoriteti Kontraktor;
- Nuk ka paraqitur deklaratën lidhur me trajnimin e stafit;
- Nuk ka paraqitur deklaratën lidhur me garancinë e mallrave objekt prokurimi jo më pak se 1(një) vit, gjatë së cilës ofertuesi do të sigurojë mirëmbajtjen e tyre pa pagesë konform specifikimeve teknike;
- Nuk ka paraqitur deklaratën se mallrat/pajisjet objekt prokurimi janë të reja dhe të papërdorura;
- Nuk ka paraqitur deklaratë se mallrat objekt prokurimi janë të certifikuara me Certifikatë Konformiteti (CE) ose ekuivalent;
- Nuk ka paraqitur asnjë dokumentë për punonjësën e kërkuar referuar kriterit 2.2.4.;
- Nuk ka paraqitur formularin e ofertës sipas Shtojcës 1;
- Nuk ka paraqitur listën e çmimeve të artikujve, sipas Shtojcës 2;

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik “TRINITY TRADE COMPANY” sh.p.k. me NUIS: K81630026U me adresë Tirane Tirane TIRANE Njesia Administrative Nr.10, Rruga Alqi Boshnjaku (ish Rruga Reshit Çollaku), Ndertesa Nr.38, Hyrja 6, Ap.1, Kodi Postar 1001, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 3,458,800 (tre milion e katërqind e pesëdhjetë e tetë mijë e tetëqind) lekë pa TVSH është identifikuar si fitues (paraparak) i procedurës së prokurimit.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020 datë 23.12.2020 “Për prokurimin Publik”.

## **AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE ( ISH ERT )**

Drejtuar: Operatorit Ekonomik “Besnik Meci” P.F, me adresë: Autostrada Tiranë-Durrës, Km.5, Kashar, Godinë një katëshe përballë QTU, Mëzes, Tiranë,

Procedura e prokurimit: “E hapur e thjeshtuar”



Numri i procedurës: REF-13059-07-12-2024

Objekt: Pjesë këmbimi për automjete, goma e bateri, shpenzime për riparime shërbime të ndryshme për automjete

Kohëzgjatja e kontratës: 4 muaj nga data e nënshkrimit të kontratës.

Buletini i Njoftimeve Publike: [22 korrik 2024] [40]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim X

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. “Auto Manoku Servis” sh.p.k. NIPT: L62311016C

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-t

Vlera: 1,254,100 (një milion e dyqind e pesëdhjetë e katër mijë e njëqind) lekë pa tvsh.

2. “Besnik Meci” P.F

NIPT: L12407012R

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-t

Vlera: 1,343,650 (një milion e treqind e dyzetë e tre mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë) lekë pa tvsh.

Nga pjesëmarrësit është skualifikuar Ofertuesi i mëposhtëm:

1. “Auto Manoku Servis” sh.p.k.

NIPT: L62311016C

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-t

Vlera: 1,254,100 (një milion e dyqind e pesëdhjetë e katër mijë e njëqind) lekë pa tvsh.

Për arsyet e mëposhtme:

Oferta e paraqitur nga operatori ekonomik rezultoi anomalisht e ulët.

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë “Besnik Meci” P.F, me adresë: Autostrada Tiranë-Durrës, Km.5, Kashar, Godinë një katëshe përballë QTU, Mëzes, Tiranë, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 1,343,650 (një milion e treqind e dyzetë e tre mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë) lekë pa tvsh, është identifikuar si fitues (paraparak) i procedurës së prokurimit.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.

## **SPITALI OBSETRIK GJINEKOLOGJIK KOCO GLIOZHENI**

Drejtuar: “IRIS” sh.p.k

Adresë: Rruga e Dibrës, Pallati Amfora, Ap 18, Tiranë

\* \* \*

Procedura e prokurimit: E Hapur

REF- 11245-06-26-2024

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “Blerje Materiale laboratorike dhe Terrenet e Kultivimit për Qëndrën e Riprodhimit të Asistuar Mjekësor (FIVET)”, MK me afat 12 muaj me një operator ekonomik ku te gjitha kushtete jane te percaktuara.

Fondi Limit: 15,177, 268 (pesëmbëdhjete milion e njëqind e shtatëdhjetë e shtate mije e dyqind e gjashtëdhjete e tetë) leke pa tvsh.

Publikimet e mëparshme (nëse aplikohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të kësaj bëjmë me dije se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë të mëposhtëm me vlerat përkatëse si më poshtë:

1.”IRIS” sh.p.k  
*Emri i plotë i shoqërisë*

J61904098H  
*Numri i NIPT-it*

Vlera e ofruar/ Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave (nëse është e zbatueshme 14,132,370 (katermbëdhjete milion e njëqind e tridhjetë e dy mije e treqind e shtatëdhjete) leke pa tvsh.

2. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë*

\_\_\_\_\_  
*Numri i NIPT-it*

Vlera e ofruar/ Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave (nëse është e zbatueshme) \_\_\_\_\_

*e shprehur në shifra dhe në fjalë)*

Etj. \_\_\_\_\_

Janë skualifikuar Operatorët ekonomikë e mëposhtëm:

Nuk ka OE te skualifikuar pasi.

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së mësipërme, ju informojmë se operatorët ekonomikë të mëposhtëm janë identifikuar si fitues (paraparak) të procedurës së prokurimit:

1.”IRIS” sh.p.k  
*Emri i plotë i shoqërisë*

J61904098H  
*Numri i NIPT-it*

Vlera e ofruar/ Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave (nëse është e zbatueshme 14,132,370 (katërmbedhjetë milion e njëqind e tridhjetë e dy mijë e treqind e shtatedhjetë) leke pa tvsh.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.

## **BASHKIA SHKODËR**

Drejtuar:Marketing & Distribution sh.p.k me NUIS J72124001N.Adresa: Autostrada Tirane - Durres, Km.10 , Kashar, Tirana

Procedura e prokurimit/lotit: Procedurë e hapur e thjeshtuar

Numri i procedurës / referenca e Lotit: REF-10490-06-21-2024

Përshkrimi i shkurtër i kontratës:

Objekti i kontratës:“Blerje materiale kancelarie për nevojat e bashkisë”

Fondi limit 5,525,308 (pesëmilion e pesëqind e njëzet e pesëmijë e treqind e tetë) lekë pa tvsh Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj: 30 (tridhjetë) ditë.

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike [01.07.2024] [34]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim X

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik Marketing & Distribution sh.p.k, NUIS J72124001N, me administrator z. Besnik Nushi.  
Vlera 3,953,577 (Tremilion e nentëqind e pesedhjetë e tremije e peseqind e shtatedhjetë e shtate) lekë pa tvsh.
2. Operatori ekonomik “Librari Dyrrahu”sh.p.k, NUIS L91418502J, me administrator z. Indrit Belegu.  
Vlera 4,340,000 (Katërmilion e treqind e dyzetmije) lekë pa tvsh.

3. Operatori ekonomik “InfoSoft” sh.p.k me administrator z. Frederik Prodani, me NUIS J62426002Q.  
Vlera 4,235,202.79 (Katermilion e dyqind e tridhjetë e pesemije e dyqind e dy pike shtatedhjetë e nente) lekë pa tvsh.
4. Operatori ekonomik IT Gjergji Kompjuter sh.p.k me administrator z. Pier Joti, me NUIS K81503063B.  
Vlera 4,607,477.80 (Katërmilion e gjashtëqind e shtatë mijë e katërqind e shtatëdhjetë e shtatë pikë tetëdhjetë) lekë pa tvsh.

Nuk ka pjesëmarrës të skualifikuar

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Marketing & Distribution sh.p.k, NUIS J72124001N, me administrator z. Besnik Nushi., me adresë: Autostrada Tirane - Durres, Km.10 , Kashar, Tirana se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 3,953,577 (Tremilion e nenteqind e pesedhjetë e tremije e peseqind e shtatedhjetë e shtate) lekë pa tvsh është identifikuar si oferta e suksesshme.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.

### **BASHKIA BELSH**

Drejtuar: Operatori ekonomik “T&J Construction shpk” me Nipt M29718101T me adrese : Elbasan Peqin,Lagjja Teqe,ZK 2908,Pasuria nr.7/90 me perfaqesues Julian Manahasa .

\* \* \*

Procedura e prokurimit/lotit: E hapur e thjeshtuar (me mjete elektronike) mall.

Numri i procedurës / referenca e Lotit: REF -12502-07-09-2024

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “Blerje materiale ndërtimi për riparimin e objekteve në Bashkinë Belsh”.

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti):Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]:

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomkisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomisht më e favorshme bazuar në çmim X

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë ka marrë pjesë Ofertuesi i mëposhtëm me këtë vlerë përkatëse të ofruar:

1. “M U R A T I”, shpk  
J66702413V

Emri i plotë i shoqërisë Numri i NIPT-it  
Vlera 1 339 125(nje milion e treqind e tridhjetë e nente mijë e njëqind e njëzet e pese) leke pa TVSH  
(e shprehur në shifra dhe fjalë)

2. “5 XH Group ”  
M11627037P

Emri i plotë i shoqërisë Numri i NIPT-it  
(e shprehur në shifra dhe fjalë)  
Vlera 1,296,300 (nje milion e dyqind e nentëdhjetë e gjashtë mijë e treqind) lekë pa TVSH

3. “Bajro Bros”, shpk  
M113130290

Emri i plotë i shoqërisë Numri i NIPT-it  
Vlera 1,432,875 (nje milion e katerqind e tridhjetë e dy mijë e tetëqind e shtatedhjetë e pese) lekë pa TVSH  
(e shprehur në shifra dhe fjalë)

4. “SPART-FRANC”, shpk  
L62612207G

Emri i plotë i shoqërisë Numri i NIPT-it  
Vlera 1.022.900 (nje milion e njëzet e dy mijë e nenteqind) leke pa TVSH  
(e shprehur në shifra dhe fjalë)

5. “T&J Construction”, shpk  
M29718101T Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it  
Vlera 1 167 570( nje milion e njëqind e gjashtedhjetë e shtate mijë e pesëqind e shtatedhje) lekë pa TVSH  
(e shprehur në shifra dhe fjalë)

Janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

- Operatori ekonomik SPART-FRANC Shpk me Nipt L62612207G me adrese :Elbasan Sheze, ZK Nr,3368 me numer pasuri 62/2,me perfaqesues Spartak Bullari është paraqitur me ofertë ekonomike 1.022.900 (nje milion e njëzet e dy mijee nenteqind) leke pa TVSH dhe 1.278.625(nje milion e dyqind e shtatedhjetee tete mijë e gjashtëqind e njëzet e pese )leke me TVSHdhe nga llogaritjet e ofertave të kualifikuara në SPE na rezulton se oferta e këtij operatori është anomalishtë e ulet.

Bazuar ne nenin 93 pika 5 i Ligjit nr.162/2020”Për Prokurimin Publik” i ndryshuar me ligjin 16/2024 është shprehur se “Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, autoritetet ose entet kontraktore refuzojnë pa kërkuar shpjegime një ofertë, e cila është konstatuar anomalisht e ulët.” Formula që do të zbatohet për të cilësuar një ofertë anomalisht të ulët, në rastin kur ka tre ose më shumë oferta të vlefshme është si më poshtë:

O – Oferta

MO – Mesatarja e Ofertave të vlefshme

n – Numri i Ofertave të vlefshme

ZM – Zbritja e Mundshme  $MO = O1 + O2 + O3 + \dots On / n$

ZM = 85 % Mo

Vlera e ofertes që vlersohet  $<..ZM.....$ ,si rrjedhim Oferta është Anomalisht e ulët Në rastin kur kriter vlerësimi është përzgjedhur oferta ekonomikisht më e favorshme, do të verifikohet nëse ofertat janë anomalisht të ulëta vetëm nëse oferta e klasifikuar me pikët më të larta e ka ofertën ekonomike me vlerën më të ulët.

Nga zbatimi i referencës së mësipërme rezulton se:

1. Murati Shpk me Nipt J66702413V me vlere 1 339 125(nje milion e treqind e tridhjetë e nente mije e njëqind e njëzet e pese) leke pa TVSH
2. 5 XH Group me Nipt M11627037P me vlere 1,296,300 (nje milion e dyqind e nentehjete e gjashte mije e treqind) lekë pa TVSH
3. Bajro Bros shpk me Nipt M11313029O me vlere 1,432,875 (nje milion e katerqind e tridhjetë e dy mije e tetëqind e shtatedhjetë e pese) lekë pa TVSH
4. SPART-FRANC Shpk me Nipt L62612207G me vlere 1.022.900 (nje milion e njëzet e dy mije e nenteqind ) leke pa TVSH
5. T&J Construction shpk me Nipt M29718101T me vlere 1 167 570( nje milion e njeqind e gjashtedhjetë e mije e pesëqind e shtatedhje) lekë pa TVSH.

Mo-Mesatarja e ofertave të vlefshme = 1 270 607,5

ZM – Zbritja e mundshme = 1 080 024 ,88

Vlerat e Ofertave me te vogla sesa 1 080 024 ,88 mije lek pa TVSH janë Oferta Anomalisht e Uleta dhe në këtë rast vlera e operatorit Spart Franc e cila është 1 022 900 leke pa Tvsh është me e vogël sesa ZM dhe konsiderohet Vlere Anomalisht e Ulet.

Per sa me sipër, oferta e operatorit ekonomik “Spart Franc” rezulton e pavlefshëm.

- Operatori ekonomik 5 XH Group me Nipt M11627037P me adresë: Tirane Rruga “Sali Nivica” Pallati 14/1 ,Shkalla 3, Njesi Administrative Nr 2,me perfaqesues Edije Xhagolli , i cili nuk është prezent në ambjentet ku po hapen ofertat, është paraqitur me ofertë ekonomikë me vlere 1,296,300 (nje milion e dyqind e nentehjete e gjashte mije e treqind) lekë pa TVSH dhe 1 555 560(nje milion e peseqind e pesedhjetë e pese mije e pesëqind e gjashtedhjet) leke me TVSH i cili nuk është prezent në ambjentet ku po hapen ofertat .Nga procedura e hapjes se ofertave KVO ka verifikuar se OE “5 XH GROUP” Ne SPE nuk hapen dokumentat

1- Dekaratat

2- Faturat

3- Vertetim Xhiro

Nga komunikimi me APP dhe udhëzimi 7/2021 eshte përgjegjësi e OE per dokumentat e ngarkuara elektronikisht ne sistem. Ndodhur ne këto kushte ku dokumentat e ngarkuara nga OE “5 XH Group”

nuk mund te verifikohen nga KVO per arsye te mos hapjes se dokumentave oferta juaj rezulton e pavlefshme

Per sa me sipër, oferta e operatorit ekonomik “5 XH Group ” rezulton e pavlefshëm.

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se “T&J Construction shpk me Nipt M29718101T me adrese : Elbasan Peqin,Lagjja Teqe,ZK 2908,Pasuria nr.7/90 me perfaqesues Julian Manahasa është paraqitur me ofertë ekonomike 1 167 570( nje milion e njeqind e gjashtedhjetë e shtate mije e pesëqind e shtatedhje) lekë pa TVSH dhe 1 401 084 (nje milion e katerqind e nje mije e tetedhjetë e kater)leke me TVSH dhe/ totali i pikëve të marra [\_\_\_\_\_]është identifikuar si fitues (paraparak) i procedurës së prokurimit.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”.

## **SHOQËRIA RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME FIER SH.A**

Drejtuar: Operatorit ekonomik “ALPHA SOLUTIONS GROUP” shpk  
Adresa: Fier Lagja Apollonia, Rr. Jakov Mile, ZK. 8534,Pasuria Nr. 3/5-B13/B21,  
kulla1, shkalla 1, Fier

NUIS L63620402U

\* \* \*

Procedura e prokurimit: E hapur, me mjete elektronike(mallra).

Numri i procedurës / referenca e Lotit: REF-09789-06-19-2024

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Blerje Matesa mekanik uji dhe aksesori” me fond limit prej 11.969.970 (njëmbëdhjetë milion e nëntëqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë) lekë pa TVSH, me burim financimi nga Buxheti i “Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Fier” Sh.a, në përputhje me sasinë, specifikimet teknike, termat e referencës dhe kushtet e përcaktuara në DST.

Objekti i prokurimit do të prokurohet, kontraktohet dhe zbatohet (lëvrohet), me vlerë dhe sasi të plotë brenda afatit të lëvrimit. Afati kohor për ekzekutimin e kontratës: nga data e nënshkrimit të kontratës deri në 12 muaj.

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [24 Qershor 2024] [32].

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

- ❑ oferta ekonomisht më e favorshme bazuar ne kosto □
- ❑ oferta ekonomisht më e favorshme bazuar në çmim PO

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë ka marrë pjesë Ofertuesi i mëposhtëm me këtë vlerë përkatëse të ofruar:

- “ALPHA SOLUTIONS GROUP” shpk me NIPT L63620402U, ka ofruar për këtë tender vlerën ekonomike në total 10,865,300 (dhjetë milion e tetëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e treqind) lekë pa TVSH, me çmime të paraqitura sipas shtojcës 1.

❖ Nuk ka të skualifikuar.

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik “ALPHA SOLUTIONS GROUP” shpk, me NIPT L63620402U dhe adresë Fier Lagja Apollonia, Rr. Jakov Mile, ZK. 8534, Pasuria Nr. 3/5-B13/B21, kulla1, shkalla 1, Fier, se oferta e paraqitur me një vlerë të përgjithshme prej 10,865,300 (dhjetë milion e tetëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e treqind) lekë pa TVSH, është identifikuar si fitues (paraparak) i procedurës së prokurimit.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”.

## **SH.A UJËSJELLËS KANALIZIME TIRANË**

Drejtuar: “M U R A T I” SH.P.K

Adresa: Dibër, Bulqizë, Rruga Ish Këshilli i Rrethit Bulqizë, Lagjja e re, Banesa 775/1, Shkalla 1, Kati 4, Apartamenti 1

Drejtuar: “A R J E I L” SH.P.K

Adresa: Tiranë, Kamëz, Bulevardi " Nënë Tereza " Objekti me numër pasurie 622

Drejtuar: “SHPRESA - AL” SH.P.K



Adresa: Tiranë, Njësia Bashkiake Nr.9, Rruga "Urani Pano", mbrapa "Veve Center", Pallati Nr.11, Kati 2

\* \* \*

Procedura e prokurimit/lotit: E hapur mbi kufirin e lartë monetar"- Mallra marrëveshje kuadër me disa operatorë ekonomikë ku jo të gjitha kushtet janë të përcaktuara.

Numri i procedurës / referenca e Lotit: Ref -06468-05-24-2024

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “ Blerje materiale ndërtimi”

Fondi limit: 44.990.050 (dyzetë e katër milion e nëntëqind e nëntëdhjetë mijë e pesëdhjetë) lekë pa Tvsh.

Publikimet e mëparshme (nëse aplikohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim X

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë ka marrë pjesë Ofertuesi i mëposhtëm me këtë vlerë përkatëse të ofruar:

1. M U R A T I SH.P.K J66702413V  
Emri i plotë i shoqërisë Numri i NIPT-it

Vlera 36.609.400 (tridhjetë e gjashtë milion e gjashtëqind e nëntë mijë e katërqind) lekë pa tvsh

2. A R J E I L SH.P.K K31320002C  
Emri i plotë i shoqërisë Numri i NIPT-it

Vlera 44.144.750 (dyzet e katër milion e njëqind e dyzet e katër mijë e shtatëqind e pesëdhjetë) lekë pa tvsh

3. SHPRESA - AL SH.P.K K31321021N  
Emri i plotë i shoqërisë Numri i NIPT-it

Vlera 44.539.000 (dyzetë e katër milion e pesëqind e tridhjetë e nëntë mijë ) lekë pa tvsh

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

S'KA OPERATOR EKONOMIK TË SKUALIFIKUAR.

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së mësipërme, ju informojmë se operatorët ekonomikë të mëposhtëm janë identifikuar si fitues (paraparak) të procedurës së prokurimit:

1. M U R A T I SH.P.K

J66702413V

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera 36.609.400 (tridhjetë e gjashtë milion e gjashtëqind e nëntë mijë e katërqind) lekë pa tvsh

2. A R J E I L SH.P.K

K31320002C

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera 44.144.750 (dyzet e katër milion e njëqind e dyzet e katër mijë e shtatëqind e pesëdhjetë) lekë pa tvsh

3. SHPRESA - AL SH.P.K

K31321021N

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera 44.539.000 (dyzetë e katër milion e pesëqind e tridhjetë e nëntë mijë ) lekë pa tvsh

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.

## **AGJENCIA E SHËRBIMEVE FUNERALE**

Drejtuar: “Blerina Sadiku” P.F

Adresa: Adresa 1: Berat Perondi Magjate Godinë një katëshe në Magjatë pranë ish-uzinës së aviacionit. Adresa2: Tiranë, Kashar, Yzberish, Rruga “Teodor Keko, zonë kadastrale 3866 pasuri 298/211-N11.

\* \* \*

Procedura e prokurimit: E hapur e thjeshtuar, mallra

Number of procedure/lot reference:

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “Blerje rroba pune” me fond limit 1,514,560.19 (një milion e pesëqind e katërbëdhjetë mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë pikë nëntëmbëdhjetë) lekë pa TVSH me REF-12830-07-11-2024.

Publikimet e mëparshme (nëse aplikohet): Buletini i Njoftimeve Publike Nr. 37 datë 15.07.2024

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomkisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomkisht më e favorshme bazuar në çmim X

Me anë të kësaj bëjmë me dije se, në këtë procedurë /lot kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë të mëposhtëm me vlerat përkatëse si më poshtë:

1. “Blerina Sadiku” P.F Numri i NIPT-it: K97730102T

Vlera: 1,467,550 (Një milion e katërqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e pesëqind e pesëdhjetë) Lekë pa TVSH

2. “Bledi Loçi” P.F Numri i NIPT-it: L47401203N

Vlera: 1,508,693 (Një milion e pesëqind e tetë mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e tre) Lekë pa TVSH

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. “Bledi Loçi” P.F Numri i NIPT-it: L47401203N

Operatori ekonomik nuk ka paraqitur në sistem dokumentacionin provues për kapacitetin ekonomik dhe financiar. Operatori ekonomik nuk ka paraqitur ne sistem dokumentacionin provues për kapacitetin teknik. Operatori ekonomik skualifikohet pasi nuk ka plotësuar të gjitha kriteret e kërkuara nga autoriteti kontraktor si dhe nuk ka sjellë mostrat në afatin e kërkuar nga autoriteti kontraktor.

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë “Blerina Sadiku” P.F me adresë: Adresa 1: Berat Perondi Magjate Godinë një katëshe në Magjatë pranë ish-uzinës së aviacionit. Adresa2: Tiranë, Kashar, Yzberish, Rruga “Teodor Keko, zonë kadastrale 3866 pasuri 298/211-N11, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 1,467,550 (Një milion e katërqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e pesëqind e pesëdhjetë) Lekë pa TVSH / totali i pikëve të marra [\_\_\_\_\_] është identifikuar si fitues (paraparak) i procedurës së prokurimit.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.

**OPERATORI I BLERJEVE TË PËRQENDRUARA**

Për: "GERTI-1987" SH.P.K

Adresa: Gjirokaster Permet Fshati Çarshove, Objekt me nr. pasurie 47/435, Zona Kadastrale 1356

\* \* \*

Procedura e prokurimit: "Procedurë e hapur Mbi Kufirin e Lartë Monetar, marrëveshje kuadër me disa operatorë ekonomikë me të gjitha kushtet e përcaktuara me objekt: "Blerje artikuj ushqimorë ndarë në 6 (gjashë) lote", me fond limit: 105,477,797 (njëqind e pesë milion e katërqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e shtatë) Lekë pa TVSH Lekë pa TVSH me nr. kryesorë të REF-06404-05-04-2024.

Përshkrim i shkurtër i kontratës: Loti IV. "Blerje ushqime Koloniale", me afat të marrëveshjes kuadër 2 (dy) vite, me fond limit të marrëveshjes kuadër: 18,483,681 (tetëmbëdhjetë milion e katërqind e tetëdhjetë e tre mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e një) lekë pa TVSH, me Loti 4: REF-06425-05-24-2024

Publikime të mëparshme (jo): Buletini i Njoftimeve Publike

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim X

Me anë të kësaj bëjmë me dije se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë të mëposhtëm me vlerat përkatëse si më poshtë:

- |  |                               |
|--|-------------------------------|
| 1) "GERTI-1987" SH.P.K<br>Emri i plotë i shoqërisë<br>Vlera: 15.227.095 (pesëmbëdhjetë milion e dyqind e njëzetë e shtatë mijë e nëntëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH (me numra dhe fjalë) | L27606201D<br>numri i NIPT-it |
| 2) "NELSA" SH.P.K<br>Emri i plotë i shoqërisë<br>Vlera: 15.518.740 (pesëmbëdhjetë milion e pesëqind e tetëmbëdhjetë mijë e shtatëqind e dyzetë) lekë pa TVSH (me numra dhe fjalë)      | J71601012S<br>numri i NIPT-it |
| 3) "M.C.CATERING"<br>Emri i plotë i shoqërisë<br>Vlera: 15.301.705 (pesëmbëdhjetë milion e treqind e një mijë shtatëqind e pesë) lekë (pa TVSH) (me numra dhe fjalë)                   | K72218022J<br>numri i NIPT-it |

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm: nuk ka

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë "GERTI-1987" SH.P.K me adresë Gjirokaster Permet Fshati Çarshove, Objekt me nr. pasurie 47/435, Zona Kadastrale 1356, se oferta e paraqitur me vlerë totale 15.227.095 (pesëmbëdhjetë milion e dyqind e njëzetë e shtatë mijë e nëntëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH është identifikuar si fitues (paraparak) i procedurës së prokurimit.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik".

Ankesa per dokumentat e tenderit: JO

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 15.07.2024

### **BASHKIA POLICAN**

Drejtuar: BOE *TOTILA SHPK*(shoqeri me pergjegjesi te kufizuar sipas QKB)me NIPT ;K13001010G ; adrese: *Berat Berat BERAT Lagjja " Çlirim ", rruga " Antipatrea ", godina me nr. pasurie 2/120, zona kadastrale 8501 dhe "METEO".SHPK*(shoqeri me pergjegjesi te kufizuar sipas QKB )me numër unik identifikimi të subjektit NIPT L26310801C, me adresë Elbasan, Pishaj CEKIN Fshati "Cekin", Rruga Nacionale Gramsh-Elbasan,ndertese private,zona kadastrale Nr. 1362,nr .pasurie 6/76,prane uzines (PERFAQESUAR NGA *TOTILA SHPK* ME PROKURË TE POSAÇME datë 13.07.2024)

Procedura e prokurimit/lotit: Procedure e hapur

Numri i procedurës / referenca e Lotit: REF-11893-07-02-2024

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: Mbrojtje lumore gjatesore e tokave bujqesore nga lumi Osum,Fshati Vodice , Poliçan me kohëzgjatje 6 muaj nga hyrja ne kantierin e punimeve.

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike [08.07.2024] [Numri 35]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1.BOE ASI-2A CO SHPK +  
K53002402C

2Z KONSTRUKSION SHPK +  
J63229466K

NIEM SHPK  
K36609610Q

*Emri i plotë i shoqërisë**Numri i NIPT-it*

Vlera 66 188 000 [ gjashtëdhjetë e gjashtë milion e njëqind e tetëdhjetë e tetë mijë )leke pa tvsh

2. BOE TOTILA SHPK +  
 “METEO”.SHPK

K13001010G  
 L26310801C

*Emri i plotë i shoqërisë**Numri i NIPT-it*

Vlera 78 004 950(shtatëdhjetë e tete milion e katër mijë e nëntëqind e pesëdhjetë) leke pa tvsh

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. BOE ASI-2A CO SHPK

K53002402C

2Z KONSTRUKSION SHPK

J63229466K

NIEM SHPK

K36609610Q

*Emri i plotë i shoqërisë**Numri i**NIPT-it*

Vlera 66 188 000 [ gjashtëdhjetë e gjashtë milion e njëqind e tetëdhjetë e tetë mijë )leke pa tvsh

**ARSYET E SKUALIFIKIMIT:** 1-Kriteri I punes se ngjashme sipas *Pika 2.3.1. b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet* nuk plotësohet nga BOE e operatoreve ekonomik pasi mbledhja e punëve të vleshme të ngjashme është në vlerën 133.287.669 leke pa tvsh kur në DST është kërkuar të jete 160 266 038 leke pa tvsh.

1/a-Gjithashtu ky kriter nuk plotësohet as nga operatori ekonomik "ASI-2A CO" shpk sipas përqindjes së punimeve do të kryej 45.8 % dhe punën e ngjashme nuk e ka sa dyfishi i kesaj vlere.

2.Kriteri i përcaktuar në pikën 2.2.1. *Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022 dhe 2023 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e përlogaritur e kontratës objekt prokurimi, nuk përputhet pasi operatori ekonomik 2Z Konstruksion nuk ka ngarkuar në sistën xhiro vjetore për asnjë vit të kërkuar*

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë BOE TOTILA (shoqeri me përgjegjesi të kufizuar sipas QKB) me NIPT ;K13001010G ; adrese: Berat Berat BERAT Lagjja " Çlirim ", rruga " Antipatrea ", godina me nr. pasurie 2/120, zona kadastrale 8501 dhe “METEO”. (shoqeri me përgjegjesi të kufizuar sipas QKB ) me numër unik identifikimi të subjektit NIPT L26310801C, me adresë Elbasan, Pishaj CEKIN Fshati "Cekin", Rruga Nacionale Gramsh-Elbasan,ndertese private,zona kadastrale Nr. 1362,nr .pasurie 6/76,prane uzines , se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 78 004 950(shtatëdhjetë e tetë milion e katër mijë e nëntëqind e pesëdhjetë) leke pa tvsh është identifikuar si fitues (paraparak) i procedurës së prokurimit.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”.

## **BASHKIA TIRANË**

Drejtuar: Operatori ekonomik "BEQIRI" shpk

Adresa: Fier, Lagjja 15 Tetori, rruga Todi Shkurta, pallati 10 katësh me nr-47/2, kati i dyte.

1.Procedura e prokurimit: "Procedurë e Hapur".

Objekti: "Ndertim Ura e Bonorakeve, Ibe e Poshtme"

2.Përshkrim i shkurtër i kontratës: Qëllimi i kontratës është: "Ndërtim Ura e Bonarakëve, Ibë e Poshtme"

3.Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-08198-06-05-2024

4.Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

5.Fondi limit: 79,515,159.68 (shtatëdhjetë e nëntë milion e pesëqind e pesëmbëdhjetë mijë e njëqind e pesëdhjetë e nëntë pikë gjashtëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH.

6.Burimi i financimit: *Të ardhurat e Bashkisë Tiranë për vitin 2024* miratuar me VKB Nr.36, date 28.03.2024 "per disa shtesa dhe ndryshime ne vendimin Nr.125, datë 22.12.2023 "Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2024-2026 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2024".

7.Kohëzgjatja e kontratës: 6 (gjashtë) muaj.

8.Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: 21 / 06 /2024 Ora 10: 00

Publikime të mëparshme: (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike: Buletini i Njoftimeve Publike Nr.30 datë 10.06.2024.

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik "S I R E T A 2F" shpk

NIPT K51501008J

Vlera e ofertës: 61,111,111.00 (gjashtëdhjetë e një milion e njëqind e njëmbëdhjetë mijë e njëqind e njëmbëdhjetë) lekë pa TVSH.

2. Bashkimi i operatoreve ekonomike GLAVENICA shpk & NGRACAN 1934 shpk  
NIPT K17710805A & J87602809S  
Vlera e ofertës: 68,573,946.00 (gjashtëdhjetë e tetë milion e pesëqind e shtatëdhjetë e tre mijë e nëntëqind e dyzet e gjashtë) lekë pa TVSH.
3. Operatori ekonomik "SENKA" shpk  
NIPT J94808405Q  
Vlera e ofertës: 71,563,582.34 (shtatëdhjetë e një milion e pesëqind e gjashtëdhjetë e tre mijë e pesëqind e tetëdhjetë e dy pikë tridhjetë e katër) lekë pa TVSH.
4. Operatori ekonomik "BEQIRI" shpk  
NIPT J98624801V  
Vlera e ofertës: 74,581,447.50 (shtatëdhjetë e katër milion e pesëqind e tetëdhjetë e një mijë e katërqind e dyzet e shtatë pikë pesëdhjetë) lekë pa TVSH.
5. Operatori ekonomik "INA" shpk  
NIPT J61814009W  
Vlera e ofertës: 78,048,245.75 (shtatëdhjetë e tetë milion e dyzet e tetë mijë e dyqind e dyzet e pesë) lekë pa TVSH.

*Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm përkatësisht për arsyt e mëposhtme:*

1. Dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik "SENKA" shpk  
Nga kontrolli aritmetik i ofertes ekonomike te paraqitur nga operatori ekonomik SENKA shpk, rezultoi se oferta e paraqitur eshte me gabim mbi 2 %.
2. Dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik "S I R E T A 2F" shpk  
Operatori ekonomik "S I R E T A 2F" shpk në Formularin Përmbledhës të Vetdeklarimit, Pjesa III, Kategoria C "Deklaratë Për disponimin e mjeteve/pajisje/makinerive të nevojshme për realizimin e punimeve objekt kontrate", ka deklaruar se disponon 1 (një) Autobetoniere me targa AA 582UZ, sipas Kontrates se Qerese Nr.6886 Rep e Nr.3332 Kol., date 02.05.2024 (me afat 5 vjar). Pas verifikimit te dokumentacionit te dorezuar, u konstatua se mungon dokumentacioni per mjetin Autobetoniere me targa AA 582UZ, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, kapaciteti teknik, pika 11.  
1. Autoriteti shites: Bashkia Poliçan, (adresa, nr. tel) Lagjia “Qender” Poliçan ; Tel:036824200 ;
2. Data e zhvillimit te ankandit:26.08.2024
3. Lloji i Procedurës standarde te ankandit : Proçedure e Hapur
4. Objekti i Shitjes: Vjelje e degezave te xinës (buqetë) ne territorin e Bashkise Poliçan dhe grumbullimi i prodhmeve te dyta pyjore te bimeve MTE
5. Përshkrim i shkurtër i objektit te shitjes: Vjelje e degezave te xinës (buqetë) ne territorin e Bashkise Poliçan” me sasi te degezave te xines 188 kv (te pasqyruara ne tabele, ne parcelat

Ekonomia Pyjore	Parcela ku eshte instaluar xina	njesia	sasia
Mali Terpan	32/b;	kv	84
Mali i Tomorrit	45/a	kv	104

Grumbullimi i prodhmeve te dyta pyjore te bimeve MTE ne sasine 200kv/cope

Ekonomia Pyjore	grumbullimi i prodhmeve te dyta pyjore te bimeve MTE	njesia	sasia
Mali i Tomorrit	flete hithre	kv	100
Mali i Tomorrit	flete ferre	kv	100

6. Vlera fillestare e ankandit eshte 218 000 dyqind e tetembedhjete mije leke
7. Sasia 188 kv xine, 100 kv hither dhe 100 kv ferre (totali 388 kv)
8. Kriteri I vleresimit: Çmimi me I larte.
9. Vendi i zhvillimit te ankandit: Bashkia Poliçan,
10. Afati i fundit për dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje; 26.08.2024 ora 11:00

11. Informacion mbi dokumentet e ankandit:

Dokumentet e ankandit mund te trerhiqen prane autoritetit shites

Dokumente me pagesë:

	Po	X	<input type="checkbox"/>	Jo	<input type="checkbox"/>
Nëse Po					
Monedha	leke	Çmimi		1000(njemije)	

Dokumentet standarde te ankandit përbehen nga:

- Formulari i njoftimit;
- Kërkesa për pjesëmarrje;
- Formulari i ofertës;
- Ftesa për oferte;
- Formulari i njoftimit te fituesit;
- Formulari i publikimit te njoftimit te fituesit;
- Procesverbalit/et i/e Komisionit te Vlerësimit te Ofertave.

13.Kërkesa për pjesëmarrje, dokumentet dhe informacionet e kërkuara dorëzohen nga kandidatet blerës ne kopje fizike, me poste ose dorazi, ne vendin e përcaktuar ne dokumentet e ankandit.

**PETROL ALBA SH.A**  
NJOFTIM ANKANDI

1. Autoriteti shitës: “PETROL ALBA” SHA .  
(adresa: “Rruga e Kavajës ” pranë Ndërmarrjes Industriale Nr.1, Kati 2, Tiranë.)
2. Data e zhvillimit të ankandit 28.08.2024 ora 10<sup>00</sup>
3. Lloji i Procedurës standarde të ankandit : Ankandi i Hapur
4. Objekti i Shitjes: “Shitje pasuri e Shoqërisë Ish Fabrika e Këpucës Korçë, truall 33,33% + ndertesë kati II, Nr.pasurie 4/421+1-2, Zona kadastrale 8561, Volum 42, Faqe 209, Korçe” në pronesi të “PETROL ALBA ” SHA në likujdim.

5. Përshkrim i shkurtër i objektit të shitjes: Shitje pasuri e Shoqërisë Ish Fabrika e Këpucës Korçë, truall 33,33% + ndertesë kati II, Nr.pasurie 4/421+1-2 Zona kadastrale 8561, Volum 42, Faqe 209, Korçe, në pronësi të “PETROL ALBA ” SHA në likuidim.
6. Vlera fillestare : 18 165 496 (tetëmbledhjetë milion e njëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e katërqind e nëntëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH.
7. Vendi i zhvillimit të ankandit: Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, salla e mbledhjeve Kati IV.
8. Afati i fundit kohor për dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje: 28.08.2024 ora 10<sup>00</sup>
9. Informacion mbi dokumentet e ankandit: Dokumentat janë bashkëngjitur dokumentave standarte.

Dokumentet e ankandit mund të tërhiqen pranë autoritetit shitës: PETROL ALBA SHA “Rruga e Kavajës ” pranë Ndërmarrjes Industriale Nr.1 Kati 2, Tiranë me paraqitjen e një kërkesë me shkrim në të cilën të jetë të specifikuar , adresa me të cilën mund të komunikohet me kandidatin blerës .

10. Dokumente me pagesë:

	Po	x	Jo	<input type="checkbox"/>
Nëse Po				
	Monedha	Lekë	Çmimi	5.000

Dokumentet standarde të ankandit përbëhen nga:

- Formulari i njoftimit;
- Kërkesa për pjesëmarrje;
- Formulari i ofertës;
- Ftesa për ofertë;
- Formulari i njoftimit të fituesit;
- Formulari i publikimit të njoftimit të fituesit;
- Procesverbal/et i/e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

11. Kërkesa për pjesëmarrje, dokumentet dhe informacionet e kërkuara dorëzohen nga kandidatet blerës në kopje fizike, me postë ose dorazi, në vendin e përcaktuar në dokumentet e ankandit.

**PETROL ALBA SH.A**  
NJOFTIM ANKANDI

1. Autoriteti shitës: “PETROL ALBA” SHA .

(adresa: “Rruga e Kavajës ” pranë Ndërmarrjes Industriale Nr.1, Kati 2, Tiranë.)

2. Data e zhvillimit të ankandit 29.08.2024 ora 10<sup>00</sup>
3. Lloji i Procedurës standarde të ankandit : Ankandi i Hapur
4. Objekti i Shitjes: “Shitje pasuri e shoqerise Oficina truall+ndertese, Nr.pasurie 1028, Volum 7, Faqe 166, Zona kadastrale 3965, Bradashesh Elbasan, ne pronesi te “PETROL ALBA ” SHA ne likujdim.
5. Përshkrim i shkurtër i objektit te shitjes: “Shitje pasuri e shoqerise Oficina truall+ndertese, Nr.pasurie 1028, Volum 7, Faqe 166, Zona kadastrale 3965, Bradashesh Elbasan, ne pronesi te “PETROL ALBA ” SHA ne likujdim.
6. Vlera fillestare : 4 570 752 ( kater milon e peseqind e shtatedhete mije e shtateqind e pesedhete e dy ) leke pa TVSH.
7. Vendi i zhvillimit të ankandit: Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, salla e mbledhjeve Kati IV.
8. Afati i fundit kohor për dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje: 29.08.2024 ora 10<sup>00</sup>
9. Informacion mbi dokumentet e ankandit: Dokumentat janë bashkëngjitur dokumentave standarte.

Dokumentet e ankandit mund të tërhiqen pranë autoritetit shitës: PETROL ALBA SHA “Rruga e Kavajës ” pranë Ndërmarrjes Industriale Nr.1 Kati 2, Tiranë me paraqitjen e një kërkesë me shkrim në të cilën të jetë të specifikuara , adresa me të cilën mund të komunikohet me kandidatin blerës .

**10. Dokumente me pagesë:**

	Po	x	Jo	<input type="checkbox"/>
Nëse Po	Monedha	Lekë	Çmimi	3.000

Dokumentet standarde të ankandit përbëhen nga:

- Formulari i njoftimit;
- Kërkesa për pjesëmarrje;
- Formulari i ofertës;
- Ftesa për ofertë;
- Formulari i njoftimit të fituesit;
- Formulari i publikimit te njoftimit të fituesit;
- Procesverbali/et i/e Komisionit te Vlerësimit te Ofertave.

11. Kërkesa për pjesëmarrje, dokumentet dhe informacionet e kërkuara dorëzohen nga kandidatet blerës ne kopje fizike, me postë ose dorazi, në vendin e përcaktuar në dokumentet e ankandit.



**QENDRA E TRANSFERIMIT TË TEKNOLOGJIVE BUJQËSORE VLORË**  
**NJOFTIM ANKANDI**

1. Autoriteti shitës: Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore Vlorë

Adresa: QTTB Vlorë - Shamogjin, Njësia Administrative: Novoselë Bashkia: Vlorë

Tel.,: 033404144

e - mail: qttbvloreproukurime@gmail.com

2. Data e zhvillimit të ankandit: 04/09/2024 ora: 10:<sup>00</sup>

3. Lloji i Proçedurës standarte të ankandit: Ankand i hapur

4. Objekti: “Shitje ulliri kokërr me lote”.

5. Përshkrim i shkurtër i objektit të shitjes: Shitje ulliri kokërr e ndarë sipas loteve.

QTTB Vlorë ka prodhuar ullinj kokërr nga Baza Eksperimentale dhe e shet atë me proçedurën e ankandit të hapur, bazuar në vlerësimin e sasisë së prodhimit dhe të vlerës së tregut të bërë nga ekspertë të ullirit, si më poshtë:

Loti 1: Ulli kokërr kultivari Kalinjot: Sasia 2000 kg, çmimi fillestar do të jetë 90 lekë/kg dhe vlera fillestare e ankandit për këtë kultivarë: 180.000 ( njëqind e tetëdhjetë mijë) lekë.

Loti 2: Ulli kokërr kultivari Frantoio: Sasia 14000 kg, çmimi fillestar do të jetë 80 lekë/kg dhe vlera fillestare e ankandit për këtë kultivarë: 1.120.000 (një milion e njëqind e njëzet mijë) lekë.

Loti 3: Ulli kokërr kultivarë të ndryshëm: Sasia 9000 kg, çmimi fillestar do të jetë 70 lekë/kg dhe vlera fillestare e ankandit për këta kultivarë: 630000 ( gjashtëqind e tridhjetë mijë leke

6. Vlera fillestare e ankandit:

Loti 1: Ulli kokërr kultivari Kalinjot me vlerë fillestare të ankandit: 180.000 ( njëqind e tetëdhjetë mijë) lekë.

Loti 2: Ulli kokërr kultivari Frantoio me vlerë fillestare të ankandit: 1.120.000 (një milion e njëqind e njëzet mijë) lekë.

Loti 3: Ulli kokërr kultivarë të ndryshëm me vlerë fillestare të ankandit: 630000 ( gjashtëqind e tridhjetë mijë leke

Nw total vlera fillestare e gjithë ankandit është 1.930.000 (një milion e nentëqind e tridhjetë mijë) lekë pa TVSH.

Vlera fillestare (pa TVSH), ka bazën kryesore ofertën e çmimit për kilogram sipas kultivarëve, sepse ulliri do të vilet sipas kohës së pjekjes së kultivarëve përcaktuar në DSA dhe oferta duhet marrë parasysh që i interesuari duhet të blejë gjithë sasinë që do të rezultojë nga vjelja, në magazinën e QTTB Vlorë bazuar në kontratën që do të bëhet me fituesin e Ankandit.

Malli do të shoqërohet me faturë e cila do të shlyhet ditën pasardhëse dhe do të dorëzohet në QTTB.

7.Vendi i zhvillimit të ankandit: QTTB Vlorë, Shamogjin, Njësia Administrative: Novoselë; Bashkia Vlorë; Tel. 033404144; e-mail: qttbvlloreprokurime@gmail.com

8.Afati i fundit kohor për dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje: datë: 04/09/2024 ora 10:<sup>00</sup>, në QTTB Vlorë.

9.Informacion mbi dokumentet e ankandit:

Dokumentet e ankandit mund të tërhiqen pranë autoritetit shitës

Dokumente me pagesë: Po

Nëse Po

Monedha Lek Çmimi 1000 leke

10.Dokumentet standarde të ankandit përbëhen nga:

- Formulari i njoftimit;
- Kërkesa për pjesëmarrje;
- Formulari i ofertës;
- Ftesa për ofertë;
- Formulari i njoftimit të fituesit;
- Formulari i publikimit të njoftimit të fituesit;

11.Kërkesa për pjesëmarrje, dokumentet dhe informacionet e kërkuara dorëzohen nga kandidatet blerës në kopje fizike, me postë ose dorazi, në vendin e përcaktuar në dokumentet e ankandit.

# **NJOFTIME FITUESI ANKANDI**

---

# **KONTRATA TË LIDHURA ANKANDI**

# **ANULLIME ANKANDI**

## **DREJTORIA E SHËRBIMIT TË TRUPIT DIPLOMATIK** ANULLIM ANKANDI

Autoriteti shitës: Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomatik, Pallati nr.4, Rruga “Skënderbej”, Tiranë, Nr. Tel. + 4 2222756

Data e zhvillimit të ankandit: 26.07.2024

Lloji i Procedurës së ankandit: Proçedurë e Hapur

Objekti i Shitjes: “Shitje skrapi të përfituara nga nxjerrja jashtë përdorimit e aktiveve të DSHTD-së”.

Vlera fillestare: Totali 113,168.829 (njëqind e trembëdhjetë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e tetë pikë tetqind e njëzet e nëntë) lekë pa TVSH.

Dta e zhvillimi të ankandit: 26.07.2024, ora 10:00, në Drejtorinë e Shërbimit të Trupit Diplomatik, Pallati nr.4, Rruga “Skënderbej”, Tiranë, Nr. Tel. + 4 2222756

Afati i fundit për pranimin e dokumentave, data: 26.07.2024, ora 10:00

Arsyet e anulimit: Mungesa e konkurrencës si rezultat i mosparaqitjes të asnjë oferte deri në afatin e fundit të pranimit të ofertave.

Ligji nr.9874, datë 14.02.2008 “Për ankandin publik”, i dryshuar, VKM Nr. nr.1719, datë 17.12.2008 “Për miratimin e rregullave të ankandit publik”, i ndryshuar, kreu VI “Kushte të përgjithshme për zbatim”, pika 6 “Mungesa e konkurrencës”, gërma “a”.

# **TË TJERA ANKANDE**

# KREU I DYTË

*Buletini*

*i*

*Departamentit*

*të Administratës*

*Publike*

# ***KREU I KATËRT***

## ***Buletini i***

### ***ofertave të qirave***



**BASHKIA DEVOLL**  
NJOFTIM FITUESI PËR DHËNIE ME QIRA

Për: “KRONOS KONSTRUKSION” SHPK me Nipt K41416033P Adresa: Bulevardi Gjergj Fishta, pranë ish ekspozitës Shqipëria Sot, Tiranë.

\* \* \*

Procedura e ankandit:

1. Përshkrim i shkurtër i procedurës së ankandit dhe objektit të tij: Dhënie me qira të sipërfaqeve nga fondi kullor me konkurim publik në pronësi të Bashkisë Devoll, Zona Kadastrale 3750, Numri i Pasurisë 1443 në ngastrën 17 dhe Numri i Pasurisë 1445 në ngastrën 18 dhe në Zonën Kadastrale 3804, Numri i Pasurisë 1728 në ngastrën 7 të cilat bëjnë pjesë në Ekonominë Kullorë “Bilisht” dhe janë në pronësi të Bashkisë Devoll.
2. Qëllimi i dhënies me qira të fondit kullor me konkurim publik në pronësi të Bashkisë Devoll, Zona Kadastrale 3750, Numri i Pasurisë 1443 në ngastrën 17 dhe Numri i Pasurisë 1445 në ngastrën 18 dhe në Zonën Kadastrale 3804, Numri i Pasurisë 1728 në ngastrën 7 të cilat bëjnë pjesë në Ekonominë Kullorë “Bilisht” e llojit “Kullote” me sipërfaqe 194.86 ha është dhënia në përdorim për zhvillimin ekonomik me destinacion për ndërtim teleferik pasagjeresh ose linjë të tensionit, Aerogjeneratorë dhe Fotovoltaikë etj.
3. Çmimi dysHEME i qirasë, është: Kullotë: 176,000 (Njëqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë) lekë/ha në vit e përlogaritur sipas VKM nr.559, datë 29.07.2022 “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore Pyjore”.
4. Afati i dhënies me qira të kësaj pasurie do të jetë 10 (dhjetë) vjet me të drejtë rinovimi.

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [35] [08.07.2024]

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:  
OE: KRONOS KONSTRUKSION” SHPK me Nipt K41416033P Adresa: Bulevardi Gjergj Fishta, pranë ish ekspozitës Shqipëria Sot, Tiranë.

Vlera e ofertuar : 177,760 (njëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë lek) lekë për Ha në vit.

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm: NUK KA

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë: “KRONOS KONSTRUKSION” SHPK me Nipt K41416033P Adresa: Bulevardi Gjergj Fishta, pranë ish ekspozitës Shqipëria Sot, Tiranë se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej: 177,760 (njëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë lek) lekë për Ha në vit është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [Bashkia Devoll] kopjen e sigurimit të kontratës, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga shpallja në Buletinin e Njoftimeve Publike së këtij njoftimi.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë: 26.07.2024

Ankesa: ka ose jo: NUK KA

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë \_\_\_\_\_

## **BASHKIA VAU DEJËS** NJOFTIM PËR DHËNIE ME QIRA

1. Fillimi i procedurave për dhënie me qira per 10 (dhjetë) vite, me anë të konkurrimit publik për sipërfaqen në total 92.34 ha e llojit “ Kullote”, ngastra nr 104 , ekonomia pyjore PrueMos Sheldi, “Për ndërtim teleferik pasagjerësh ose linjë të tensionit, aerogjenerator dhe fotovoltai(stacionet, bazamentet, objektet përkatëse etj)”, sipas Udhëzimit nr.1, datë 9.6.2016, “Për rregullat, procedurat e kërimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të Fondit Pyjor dhe Kullosor Publik”.
2. Çmimi dysheme i fillimit të konkurrimit është 176.000 ( njëqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë) lekë/ha në vit për sipërfaqe të llojit “Kullote” dhe për 92.34 ha është 16.251.840 (gjashtëmbëdhjetë milion e dyqind e pesëdhjetë e një mijë e tetëqind e dyzet)lekë në vit për sipërfaqe të llojit “ Kullote”, ndërsa për 0.324 km rrugë x 35 000 lekë/km = 11 340 lekë në vit, pra në total çmimi dysheme është 16 263 180 (gjashtëmbëdhjetë milion e dyqind e gjashtëdhjetë e tre mijë e njëqind e tetëdhjetë)lekë e përlogaritur kjo sipas VKM-së nr. 559, datë 29.7.2022, “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore Pyjore”, dhe sipas Raportit mbi Studimin Tekniko-Ekonomik, përgatitur nga specialistët e fushës.
3. Qëllimi i përdorimit është dhënia në gëzim të përkohshëm të sipërfaqes pyjore Për ndërtim teleferik pasagjerësh ose linjë të tensionit, aerogjenerator dhe fotovoltai(stacionet, bazamentet, objektet përkatëse etj)”.
4. Pikët vlerësuese sipas kriterëve të konkurrimit për subjektet pjesëmarrëse në konkurrim, sipas pikës 14 të udhëzimit nr.1, datë 9.6.2016, “Për rregullat, procedurat e kërimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të Fondit Pyjor dhe Kullosor Publik”, do të jenë :

Nr .	Lloji i Kriterit	Pesha e matur në pike e kriterit vlerësues (e shprehur në pikë)

1	Projekti teknik i veprimtarisë që do të ushtrohet, i cili përmban hartën topografike me koordinatat e sipërfaqes objekt përdorimi në variantin PDF dhe në format elektronik në shkallë 1:10 000 ku të jenë evidentuar elementet kryesore, si: kufijtë natyrorë, relievi, objektet aktuale, si dhe çdo planimetri tjetër në shkallë më të detajuar, hartuar konform kërkesave të projektit	20
2	Planbiznesi dhe investimet që do të bëhen	15
3	Planin e rehabilitimit të sipërfaqes	25
4	Nivelin e punësimit në veprimtari	5
5	Masën e qirasë për lek/ha/vit	35

5. Dokumentacioni që duhet të plotësohet nga konkurrentët për konkurrim, sipas pikës 10 të udhëzimit nr.1, datë 9.6.2016, “Për rregullat, procedurat e kërimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të Fondit Pyjor dhe Kullosor Publik”, është:

- a) kërkesë së bashku me të dhënat për gjeneralitetet e tyre;
- b) ekstraktin e regjistrimit në QKR për objektin e veprimtarisë;
- c) projektin teknik të hartuar nga specialistë të licencuar ku janë trajtuar të gjitha elementet e nevojshme për zhvillimin e veprimtarisë;
- d) planbiznesin dhe investimet që do të bëhen;
- e) të dhëna për kapacitet teknike, stafin, makineritë dhe pajisjet që zotëron;
- f) planin e rehabilitimit të sipërfaqes dhe kthimin e saj në gjendjen e mëparshme;
- g) nivelin e punësimit në veprimtari;
- h) lejen mjedisore për aktivitetin e kërkuar/vlerësimin paraprak të ndikimit në mjedis, (VNM)
- i) çmimin e qirasë së ofruar për ha/vit;
- j) adresën e subjektit, telefon, email, dhe faks.

6. Kushtet e pjesëmarrjes në konkurrim, sipas pikës 11 të udhëzimit nr.1, datë 9.6.2016, “Për rregullat, procedurat e kërimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të Fondit Pyjor dhe Kullosor Publik”, janë:

- a) garanci financiare të mjaftueshme për përballimin e investimeve të parashikuara në planbiznes;
- b) të ketë të kontraktuar një specialist të fushës, ku në CV-në profesionale të tregohet përvoja në fushën e veprimtarisë;
- c) vërtetim nga organet përkatëse shtetërore se subjekti nuk ka procese gjyqësore në ngarkim, hetim në proces, detyrime tatimore ose detyrime të tjera ndaj të tretëve.

Të gjitha dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

7. Vendi i zhvillimit të konkurimit: (Adresa): Zyra e Prokurimeve Publike, Bashkia Vau Dejës.

8. Afati i fundit kohor për dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje: me date 16.08.2024, ora 09:00.

9. Informacion mbi Dokumentet e Konkurrimit Publik:

Dokumentet e Konkurrimit Publik mund të tërhiqen pranë Autoritetit Qiradhënës

Dokumente me pagesë:

---

	Po	X	Jo	<input type="checkbox"/>
Nëse Po	Monedha	leke	Çmimi	1500

Dokumentet Standarde të Konkurrimit Publik përbëhen nga:

- Formulari i Njoftimit;
- Kërkesa për Pjesëmarrje;
- Formulari i Sigurimit të Ofertës;
- Formulari i Ofertës;
- Ftesa për Ofertë;
- Formulari i Njoftimit të Fituesit;
- Formulari i Publikimit të Njoftimit të Fituesit;
- Procesverbali/et i/e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

10. Kërkesa për pjesëmarrje, dokumentet dhe informacionet e kërkuara dorëzohen nga kandidatët pjesëmarrës në kopje fizike, me postë ose dorazi, në vendin e përcaktuar në dokumentet e konkurimit.

**PROCEDURA KONKURRUESE PËR**  
**LEJE MINERARE**

# **NJOFTIME TË TJERA**

## **DREJTORIA E SPITALI RAJONAL FIER**

### **Njoftim për vend të lirë pune**

Në zbatim të Udhëzimit nr. 206, datë 9.4.2024 “Për procedurat e punësimit, emërimit, pezullimit, lirimit dhe të disiplinës të punonjësve të administratës në DQOSHKSH, DROSHKSH, NJVKSH dhe Drejtoritë e shërbimit spitalor në varësi të OSHKSH-së; në Strukturën Analitike të Drejtorisë së Spitalit Rajonal Fier, të miratuar me shkresën nr. 366 prot datë 23.01.2023, nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Drejtoria e Spitalit Rajonal Fier, shpall konkursin për 1 (një) vend të lirë pune, Pozicioni: Arkëtare në Sektorin e Financës pranë Spitalit Fier.

Kandidatët që konkurojnë për vendin e lirë të punës duhet të plotësojnë këto kriteret:

- Të kenë mbaruar minimalisht arsimin e mesëm .
- Të kenë aftësi të mira komunikuese.
- Të kenë aftësi të mira menaxhuese për punën në grup.

Përshkrimi përgjithësues i punës

Arketari është përgjegjës për mbarvatjen e gjendjes kontabel të arkës dhe arketimeve ditore për mos kalim të limitit ditor si dhe aktivitetit të arkave.

1. Zbaton aktivitetin e arkës dhe mbyllcdo ditë librine arkës. Përgjigjet për zbatimin e limitit të arkës.
2. Mban dhe ndjek rregullisht veprimet dhe librin e arkës.
3. Nuk kryen veprime nga arka që bien në kundërshtim me ligjet në fuqi.
4. Zbaton me përpikëri Sistemin e referimit dhe tarifat e shërbimit shëndetësor publik.
5. Çdo ditë bën derdhjen në Bankë të të ardhurave të mbedhura në arkë ,nga klientët.
6. Dorëzon dokumentacionin e arkës tek specialisti parë i financës duke rakorduar me të.

Paraqitja e dokumentave : Kandidati/ja duhet të paraqesë në sekretarinë e Drejtorisë së Spitalit Rajonal Fier Brenda një jave nga data e botimit të këtij njoftimi në Buletinin e APP këto dokumenta:

- Kërkesën me shkrim për aplikim
- Curriculum Vitae (Jetëshkrimin)

- Fotokopje të noterizuar të diplomës dhe listës së notave të arsimit përkatës.

- Fotokopje e noterizuar e librezës së punës( n.q.s ka qënë i punësuar ).
- Dëshmi të aftësisë shëndetësore për punë e tre muajve të fundit .
- Fotokopje të kartës identitetit.
- Referencë pune ( n.q.s ka qënë i/e punësuar), nga punëdhënësi i mëparshëm.
- Vërtetim nga Gjykata.
- Vërtetim nga Prokuroria.
- Vërtetim i gjendjes gjyqësore lëshuar nga Ministria e Drejtësisë (Dëshmi penaliteti e tre muajve te fundit).
- Çertifikatë familajre
- Çertifikatë personale

Mosparaqitja e dokumentave ose mosparaqitja e plotë e tyre, sjell s'kualifikim të kandidatit.

Dokumentacioni i dorëzuar nuk do të kthehet mbrapsht, pasi do të bëhet pjesë e arkivës së institucionit.

Konkurimi është i hapur si për punonjësit brenda spitalit si dhe për personat nga jashtë.

Kanidatët e interesuar duhet të paraqesin dokumentat në sekretarinë e Drejtorisë së Spitalit Rajonal Fier brenda një jave nga data e publikimit të këtij vendimi.

## **INSTITUTI I SHËNDETIT PUBLIK**

### **Njoftim për vend të lirë pune**

Instituti i Shëndetit Publik shpall pozicionet e punës si vijon:

- 1.** Specialist, Sektori i Promocion/Ndërgjegjësimit Shëndetësor në Departamentin e Performancës Shëndetit Publik dhe Sëmundjeve Kronike (1 Vend Pune)

Përshkrimi i përgjithshëm i punës për pozicionin si më sipër është:

- Të shkruajë artikuj shkencor në buletin e ISHP-së apo revista të tjera shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare.
- Të marrë pjesë në hartimin e dokumenteve strategjike të lidhur me promocionin shëndetësor.
- Planifikon aktivitetet që do të realizojë sektori për një afat kohor të caktuar.
- Të përgatisë materiale informative dhe programimin për shpërndarjen e informacionit në varësi të audiencës target etj.
- Zhvillon dhe prezanton programe në fushën e sEdukimit dhe Promocionit të Shëndetit, të tilla si trajnime, ëorkshop-e, dhe prezantime në mjedise të ndryshme: shkollë, institucione shëndetësore dhe komunitet.

Kandidati për vendin e punës “Specialist, Sektori i Promocion/Ndërgjegjësimit Shëndetësor në Departamentin e Performancës Shëndetit Publik dhe Sëmundjeve Kronike” duhet të plotësojë këto kritere:

- Të ketë përfunduar Arsimin e Lartë, Mjekësi të Përgjithshme;
- Të ketë eksperiencë pune mbi 10 vite, në fushën e mjekësisë;
- Të ketë aftësi komunikuese dhe të punuarit në grup;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë nga gjykata;
- Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze;

Kandidatët aplikantë për vendin e punës kërkohet të plotësojnë edhe këto kritere preferenciale:

- Të ketë të paktën Gradën Shkencore “Doktor” në fushën e mjekësisë;
- Të ketë njohuri të legjisllacionit të shëndetit publik;

2.Specialist, Laboratori Biologjisë Molekulare në Sektorin e Laboratorëve të Referencës Kombëtare për Kontrollin e Sëmundjeve Infektive pranë Departamentit të Laboratorëve të Referencës Kombëtare (1 Vend Pune)

Përshkrimi i përgjithshëm i punës për pozicionin si më sipër është:

- Kryen zhvillimin dhe përditësimin në sasi dhe cilësi të diagnozës laboratorike me anë të metodave molekulare për ngarkesën virale të Hepatiteve HBV, HCV.
- Si pjesë e Programit Kombëtar të depistimit të kancerit të qafës së mitrës, identifikimi me metoda molekulare i infeksionit me HPV si shkaktari kryesor i kancerit të qafës së mitrës.
- Vlerësimi i praktikave të mira laboratorike, përgatitja dhe zbatimi i protokolleve të reja laboratorike etj.

Kandidati për vendin e punës “Specialist, Laboratori Biologjisë Molekulare në Sektorin e Laboratorëve të Referencës Kombëtare për Kontrollin e Sëmundjeve Infektive pranë Departamentit të Laboratorëve të Referencës Kombëtare” duhet të plotësojë këto kritere:

- Të ketë përfunduar Arsimin e Lartë, dega Biologji;
- Të zotërojë diplomë të nivelit “Master Profesional /Shkencor;
- Të ketë aftësi komunikuese dhe të punuarit në grup;
- Të ketë notë mesatare universitare mbi 8;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë nga gjykata;
- Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze;

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë, do të vlerësohen në lidhje me:

- Njohuritë, aftësitë në lidhje me përshkrimin përgjithësues të punës për pozicionin;
- Motivimin në punë, personalitetin, njohjen e gjuhëve të huaja, aftësinë komunikuese;

Mënyra e vlerësimit:

Kandidatët do të vlerësohen bazuar në Urdhërin Nr.511, datë 13.12 2011 “Për kriteret e Punësimit në Shërbimin Shëndetësor Publik” të Ministrisë së Shëndetësisë.



Përcaktimet vlerësuese:

Nota mesatare

Mbi 9 vlerësohet me 15 pikë

Mbi 8 vlerësohet me 12 pikë

Mbi 7 vlerësohet me 8 pikë

Mbi 6 vlerësohet me 4 pikë

Mbi 5 vlerësohet me 2 pikë

Grada apo titulli shkencor/specializim vlerësohet me 20 pikë

Gjuha e huaj e vërtetuar vlerësohet 3 pikë

Përvoja mbi 10 vjet vlerësohet 5 pikë

Intervista (maksimalisht) vlerësohet 10 pikë

✓ Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë Protokollit në Institutin e Shëndetit Publik këto dokumenta:

1. Kërkesë me shkrim për aplikim;
2. Jetë shkrimin (CV);
3. Fotokopjetë pasaportës ose kartës së identitetit;
4. Kopje e noterizuar e diplomës, bashkë me listën e notave të noterizuara;
5. Kopje e noterizuar e librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
6. Kopje e noterizuar e çertifikatë/dëshmi që vërteton njohuritë programit të paketës MicrosoftOffice;
7. Kopje e noterizuar e dëshmisë së njohjes një nga gjuhët e huaja perëndimore (Anglisht,Frëngjisht, Italisht);
8. Vërtetimi gjendjes shëndetësore të marrë brenda tre muajve të fundit (raport mjekësor për aftësinë në punë);
9. Dëshmi Penaliteti të marrë brenda tre muajve të fundit;
10. Vërtetim nga Gjykata dhe Prokuroria që nuk ndiqet penalisht;
11. Formulareve të deklarimit sipas formës së kërkuar nga ligji nr. 138/2015;
12. Çdo dokument tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet apo të tjera të përmendura në jetëshkrim;
13. Vërtetim nga punëdhënësi mëparshëm (i fundit) që nuk ka masë disiplinore;
14. Referenca nga punëdhënësi të mëparshëm, që provojnë vlerësimet positive në punë;
15. Leja e ushtrimit të profesionit (nëse ka);
16. Certifikate familjare dhe vërtetim banimi;

Pranimi i dokumentave është 10 (dhjetë) ditë kalendarike nga data e publikimit në Buletinin e APP-së.

Mosparaqitja e plotë e dokumentacionit të sipërcituar brenda afatit të përcaktuar në shpallje, sjell skualifikimin e kandidatit.

Përzgjedhja e kandidatit fitues do të bëhet nëpërmjet konkurimit me dosje dhe me intervista të drejtëpërdrejta.Për çdo paqartësi mund të dërgoni email në adresën ishp@shendetesia.gov.al.

## **TEATRI KOMBËTAR I OPERËS, BALETIT DHE ANSAMBLIT** **POPULLOR**

### **Njoftim për vend të lirë pune**

TKOBAP, në zbatim të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjit nr. 44/2015 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”, ligjit nr. 90, datë 27.09.2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, ligjit nr. 10 352, datë 18.11.2010 “Për artin dhe kulturën”, i ndryshuar, VKM-së nr. 176, datë 29.03.2006 “Për botimin e buletinit të njoftimeve publike”, Urdhrit të Kryeministrit nr.140, datë 28.03.2014 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës të TKOBAP”, Statutit të TKOBAP-së miratuar me urdhër të Ministrit të Kulturës nr. 166, datë 27.04.2015 dhe Rregullores së Brendshme për Organizimin dhe Funksionimin e TKOBAP-së, shpall 1 (një) vend vakant për pozicionin e punës “Drejtor pranë Drejtorisë së Produksionit Skenik”.

Kërkesat e përgjithshme që duhet të plotësojnë personat që aplikojnë:

1. Të jetë shtetas shqiptar;
2. Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
3. Të përmbushë kërkesat ligjore për nivelin arsimor dhe të zotërojë aftësitë e nevojshme profesionale për vendin përkatës të punës;
4. Të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
5. Ndaj tij të mos jetë marrë masë disiplinore e largimit nga puna për shkak të një shkeljeje të rëndë disiplinore.

Kërkesat e posaçme që duhet të plotësojnë personat që aplikojnë:

1. Të ketë përfunduar studimet në degën e skenografisë, regjisorës ose arkitekturës brenda ose jashtë vendit;
2. Të ketë përvojë jo më pak se 3 (tre) vjet pune në pozicione drejtuese;
3. Të ketë aftësi koordinimi dhe organizimi të procesve të punës në ngarkim;
4. Të ketë aftësi të dallueshme komunikimi në ruajtje dhe zhvillim të kontakteve brenda dhe jashtë institucionit;
5. Të ketë njohuri të mira të gjuhëve të huaja (preferohet anglisht dhe italisht).

Përgjegjësitë/Detyrat kryesore të Drejtorit pranë Drejtorisë së Produksionit Skenik:

1. Ka përgjegjësinë për përcaktimin e objektivave dhe planifikimin e veprimtarisë së Drejtorisë së Produksionit Skenik duke organizuar dhe koordinuar proceset e punës në ngarkim të kësaj drejtorie.
2. Ka përgjegjësinë për ndjekjen e proceseve të punës të produksioneve të shfaqjeve që vihen në skenën e TKOBAP-së dhe jashtë saj në të gjitha fazat duke organizuar edhe takime mbi problematikat e hasura dhe mbarëvajtjen e punës.
3. Ka përgjegjësinë për organizimin e punës për prodhimin e dekoreve, kostumeve, rekuizitës etj., të të gjitha shfaqjeve që vihen në skenën e TKOBAP-së duke duke bashkërenduar punën me punonjësit nën varësi dhe me punonjësit pranë drejtorive të tjera për realizimin e tyre.

4. Ka përgjegjësinë mbi planifikimin e ndriçimit dhe fonisë në raport me shfaqjet e Kalendarit Artistik të TKOBAP-së.
5. Ka përgjegjësinë mbi planifikimin, montimin dhe provat në skenë sipas kërkesave të regjisë.
6. Ka përgjegjësinë për dhënien e ndihmës në përgatitjen e planit financiar të shfaqjeve sipas Kalendarit Artistik të TKOBAP-së.
7. Ka përgjegjësinë, në bashkëpunim me zyrën e burimeve njerëzore, për të ndjekur disiplinën në punë si dhe shfrytëzimin e drejtë të kohës së punës për realizimin sa më cilësor të Kalendarit Artistik.
8. Ka përgjegjësinë mbi planifikimin në raport me shfaqjet e Kalendarit Artistik të kontratave me te tretët për përmbushjen në kohë dhe me cilësi të detyrave në zbatim të objektivave të drejtorisë dhe porosive të titullarit të institucionit.
9. Ka përgjegjësinë për udhëzimin e punonjësve nën varësi për përmbushjen e aktivitetit të përditshëm të drejtorisë dhe siguron që kjo veprimtari të jetë në përputhje me politikat institucionale dhe standardet përkatëse.

Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit të tyre:

1. Letër shprehje interesi për pozicionin e punës së shpallur;
2. Jetëshkrimi (CV);
3. Fotokopje të mjetit të identifikimit;
4. Diploma, suplementi dhe lista e notave të noterizuara. Në rast se arsimimi është kryer jashtë vendit, të depozitohet edhe dokumenti i njohjes së tyre nga institucionet përkatëse sipas legjislacionit të arsimit të lartë;
5. Çdo dokument tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive, tituj artistikë, rekomandime apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin e aplikantit;
6. Libreza e punës e noterizuar ose vërtetim mbi pagesën e kontributeve;
7. Dëshmi e gjendjes gjyqësore;
8. Vërtetim të gjendjes shëndetësore.

Mosparaqitja e plotë dhe në kohë e dokumenteve sjell skualifikimin e aplikantit.

Dokumentacioni do të dorëzohet pranë Zyrës së Protokollit ose i skanuar në adresën në postën elektronike zyrtare të TKOBAP-së deri në datën 30.08.2024 me objekt:

Aplikim për pozicionin e punës “Drejtor pranë Drejtorisë së Produksionit Skenik”.

Pas verifikimit të dokumentave të depozituara, aplikantët të cilët plotësojnë kriteret e kërkuara, do të lajmërohen nëpërmjet e-mail-it për zhvillimin e intervistës së strukturuar me gojë brenda 7 (shtatë) ditëve nga afati i fundit për dorëzimin e dokumentacionit të kërkuar për pozicionin e punës.

**TEATRI KOMBËTAR I OPERËS, BALETIT DHE ANSAMBLIT  
POPULLOR****Njoftim për vend të lirë pune**

Teatri Kombëtar i Operës, Baletit dhe Ansamblit Popullor, në zbatim të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, ligjit nr. 90, datë 27.09.2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, ligjit nr. 10 352, datë 18.11.2010 “Për artin dhe kulturën”, i ndryshuar, VKM-së nr. 176, datë 29.03.2006 “Për botimin e buletinit të njoftimeve publike”, Urdhrit të Kryeministrit nr.140, datë 28.03.2014 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës të TKOBAP”, Statutit të TKOBAP-së miratuar me urdhër të Ministrit të Kulturës nr. 166, datë 27.04.2015 dhe Rregullores së Brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e TKOBAP-së”, shpall audicionin për pozicionin e punës “Solist i Dytë Lirik (Tenor)” pranë Drejtorisë së Operës dhe Filarmonisë.

Kërkesat e përgjithshme që duhet të plotësojnë personat që aplikojnë:

1. Të jetë shtetas shqiptar ose i huaj
2. Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse
3. Të përmbushë kërkesat ligjore për nivelin arsimor dhe të zotërojë aftësitë e nevojshme profesionale për vendin përkatës të punës
4. Të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje
5. Ndaj tij të mos jetë marrë masë disiplinore e largimit nga puna për shkak të një shkeljeje të rëndë disiplinore
6. Të ketë njohuri të gjuhëve të huaja (preferohet anglisht dhe italisht).

Programi për konkurimin është interpretimi i roleve të plota (përzgjedhja e roleve për interpretimin nga kandidatët do të bëhet Komisioni i Vlerësimit) nga veprat e mëposhtme:

Verdi: “La Traviata”

Verdi: “Rigoletto”

Verdi: “Macbeth”

Puccini: “La Boheme”

Puccini: “Madama Butterfly”

Donizetti: “Lucia Di Lammermoor”

Puccini: “Messa Di Gloria”

Mozart: “Messa Di Requiem”

Audicioni do të zhvillohet më 10.9.2024, ora 14:00 në Hollin e Katit të Dytë pranë Teatrit Kombëtar të Operës, Baletit dhe Ansamblit Popullor.

Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit të tyre:

1. Letër shprehje interesi për pozicionin e punës së shpallur
2. Jetëshkrimi (CV)
3. Fotokopje të mjetit të identifikimit
4. Diploma (për kanto brenda ose jashtë vendit), suplementi dhe lista e notave të noterizuara. Nëse aktualisht jeni në përfundim të studimeve të larta në nivelin Master, të depozitohet diploma Bachelor dhe lista e notave të noterizuara. Në rast se arsimimi është kryer jashtë vendit

depozitohet edhe dokumenti i njohjes së tyre nga institucionet përkatëse sipas legjislacionit të arsimit të lartë

5. Çdo dokument tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive, rekomandime apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin e kandidatit
6. Libreza e punës e noterizuar ose vërtetim mbi pagesën e kontributeve
7. Dëshmi e gjendjes gjyqësore.

Mosparaqitja e plotë dhe në kohë e dokumenteve sjell skualifikimin e aplikantit.

Dokumentacioni do të depozitohet pranë Zyrës së Protokollit ose i skanuar në adresën në postën elektronike zyrtare të TKOBAP-së sekretaria@tkob.gov.al deri në datën 3.9.2024 me objekt: Aplikim për pozicionin e punës “Solist i Dytë Lirik (Tenor)” pranë Drejtorisë së Operës dhe Filarmonisë.

Pas verifikimit të dokumentave të depozituara, aplikantët të cilët plotësojnë kriteret e kërkuara, do të lajmërohen nëpërmjet e-mail-it për zhvillimin e audicionit brenda 7 (shtatë) ditëve nga afati i fundit për dorëzimin e dokumentacionit të kërkuar për pozicionin e punës.

## **SHËRBIMI SOCIAL SHTETËROR**

### **Njoftim për vend të lirë pune**

Në mbështetje të VKM nr. 135, datë 07.03.2018 “Për miratimin e Statutit të Shërbimit Social Shtetëror” i ndryshuar, Shërbimi Social Shtetëror shpall konkurimin për:

Specialist (Mjek), në Sektorin e Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar, pranë Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Tiranë.

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati/ja:

- Të jetë shtetas shqiptar;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të ketë përfunduar arsimin e lartë në Fakultetin e Mjekësisë;
- Të jetë i/e pajisur me licencën e mjekut;
- Preferohet të ketë eksperiencë pune në profesion;
- Të ketë aftësi për të zbatuar përgjegjësitë dhe realizimin e objektivave të institucionit;
- Të jetë i përkushtuar dhe i komunikueshëm për zbatimin e detyrave;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e ndonjë vepre penale;
- Të mos jetë dhënë ndaj tij/saj masa disiplinore e largimit nga puna.

Kandidatët duhet të paraqesin brenda datës 12.08.2024, në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror, këto dokumente:

- Kërkesën për aplikim;
- Jetëshkrimin (CV);
- Fotokopje të diplomës dhe listës së notave;
- Fotokopje të librezës së punës;
- Fotokopje të kartës së identitetit;
- Dëshmi penaliteti ose vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
- Çertifikatë familjare;
- Vërtetim banimi;
- Raport mjekësor që vërteton gjendjen shëndetësore;
- Çertifikata të kualifikimeve;
- Referenca pune.

Pas verifikimit paraprak në datën 14.08.2024, do të shpallet lista e konkurentëve që plotësojnë kushtet e përgjithshme, si dhe data kur do të zhvillohet intervista me gojë.

Konkurimi do të bazohet në njohuri specifike për pozicionin e punës të cilat kanë të bëjnë me:

1. Ligji Nr. 57/2019, “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
2. VKM Nr. 722, datë 11.11.2019 “Për përcaktimin e masës, të kriterëve, procedurave dhe dokumentacionit për vlerësimin dhe përfitimin e aftësisë së kufizuar e të ndihmësit personal, dhe të strukturave përgjegjëse e të detyrave të tyre”.

Të gjitha njoftimet për shpalljen e vendit të lirë të punës, rezultatet e verifikimit paraprak si dhe datën kur do zhvillohet testimi, i gjeni në adresën: [www.sherbimisocial.gov.al](http://www.sherbimisocial.gov.al)

## **BANKA E SHQIPËRISË** **TENDER I HAPUR KOMBËTAR**

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: “Blerje letër fashetimi për makinat BPS, plasmas për makinat NotaPack dhe shirit plastik, për nevojat e Bankës së Shqipërisë”.

“Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit “Tender i hapur kombëtar”, për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me fond limit 2,456,000 Lekë”. Kandidatët e interesuar mund të pajisen me dokumentet e tenderit, si më poshtë:

- a. Pranë Sektorit të Prokurimit të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Selia Qendrore Nr. 2 e Bankës së Shqipërisë, Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Nr. 3,

Tiranë (Ish-Hotel Dajti), Tel: 042 419 411, (ext: 214), çdo ditë me paraqitjen e përfaqësuesit të kandidatit, vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e pakthyeshme prej 500 lekësh, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë, sipas detajeve të mëposhtme:

Përfituesi: Banka e Shqipërisë

BIC: STANALTR

IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përshkrimi: Blerje dokumente tenderi me objekt: “Blerje letër fashetimi për makinat desktop, letër fashetimi për makinat BPS, plasmas për makinat NotaPack dhe shirit plastik, për nevojat e Bankës së Shqipërisë”; ose

- b. Në formë elektronike, pas paraqitjes së kërkesës nga përfaqësuesi i kandidatit, në adresën elektronike të Bankës së Shqipërisë: [avaraku@bankofalbania.org](mailto:avaraku@bankofalbania.org).

Në kërkesë duhet të citohet qartë objekti i prokurimit, emri i subjektit, NIPT-i, të dhënat e kontaktit si: adresa, numri i telefonit dhe e-mail-i ku do të dërgohen dokumentet e tenderit.

Oferta duhet të paraqitet në adresën: Banka e Shqipërisë, Selia Qëndrore Nr. 2 e Bankës së Shqipërisë, Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Nr. 3 , Tiranë (Ish-Hotel Dajti), deri më datë 19 Gusht 2024, ora 10:00, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

## **BANKA E SHQIPËRISË** TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: “Rinovimi i Software Subscription për 6 licenca IBM SPSS Statistics”.

“Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit “Tender i hapur kombëtar”, për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me fond limit 1,300,000 Lekë”. Kandidatët e interesuar mund të pajisen me dokumentet e tenderit, si më poshtë:

- c. Pranë Sektorit të Prokurimit të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Selia Qëndrore Nr. 2 e Bankës së Shqipërisë, Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Nr. 3, Tiranë (Ish-Hotel Dajti), Tel: 042 419 411, (ext: 214), çdo ditë me paraqitjen e përfaqësuesit të kandidatit, vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e pakthyeshme prej 500 lekësh, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë, sipas detajeve të mëposhtme:

Përfituesi: Banka e Shqipërisë

BIC: STANALTR

IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përshkrimi: Blerje dokumente tenderi me objekt: “Rinovimi i Software Subscription për 6 licenca IBM SPSS Statistics”; ose

- d. Në formë elektronike, pas paraqitjes së kërkesës nga përfaqësuesi i kandidatit, në adresën elektronike të Bankës së Shqipërisë: [avaraku@bankofalbania.org](mailto:avaraku@bankofalbania.org).

Në kërkesë duhet të citohet qartë objekti i prokurimit, emri i subjektit, NIPT-i, të dhënat e kontaktit si: adresa, numri i telefonit dhe e-mail-i ku do të dërgohen dokumentet e tenderit.

Oferta duhet të paraqitet në adresën: Banka e Shqipërisë, Selia Qëndrore Nr. 2 e Bankës së Shqipërisë, Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Nr. 3 , Tiranë (Ish-Hotel Dajti), deri më datë 20 Gusht 2024, ora 10:00, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.